



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 187 Akti

Nr. 242 Vendimi
Tiranë, më 28.2.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Etleda Çiftja	Relatore
Suela Zhegu	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 24.2.2020, ora 10:00 dhe në datën 28.2.2020, ora 9:30, në Pallatin e Koncerteve, kati i 0 (zero), zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Asim Vokshi, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.**

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, z. Asim Vokshi, dhe pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, i

cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Z. Asim Vokshi është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Z. Asim Vokshi, bazuar në nenin 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 17.9.2019 me trupin gjykues të përbërë nga komisioneret:

Genta Tafa (Bungo)

Suela Zhegu

Etleda Çiftja

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 – 33, të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016; dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ), sipas neneve 40 - 44, të ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin nr. 1, datë 17.9.2019, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit; të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Genta Tafa (Bungo). Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, datë 4.2.2020, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit, z. Asim Vokshi, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar bashkë me nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarin e konfliktit të interesit, me të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.

6. Në datën 5.2.2020, përmes postës elektronike¹, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, jo më vonë se data 17.2.2020; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40, të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në datën 17.2.2020, subjekti rivlerësimit, me anë të postës elektronike², dërgoi shpjegimet dhe provat e tij në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ kryesisht, ku dhe kishte kërkuar thirrjen si dëshmitar të z. A.V., z. B.V., z. H.V. dhe z. A.V., për të vërtetuar të ardhurat nga trashëgimia të përfituara nga babai i tij dhe të ardhurat nga aktiviteti privat i prindërve për vitet 1994 - 1997.

8. Në datën 20.2.2020, trupi gjykues njoftoi subjektin me anë të postës elektronike³, se pasi administroi dhe shqyrtoi kërkesën e subjektit për thirrjen si dëshmitar të z. A.V., z. B.V., z. H.V. dhe z. A.V., për të vërtetuar të ardhurat nga trashëgimia të përfituara nga babai i tij dhe të ardhurat nga aktiviteti privat i prindërve për vitet 1994 - 1997, vendosi refuzimin e kërkesës, bazuar në germat “a” dhe “d”, të pikës 6, të nenit 46, të ligjit nr. 84/2016.

9. Në datën 21.2.2020, me anë të postës elektronike⁴, trupi gjykues i kërkoj subjektit të japë shpjegime gjatë seancës dëgjimore, për një denoncim të administruar nga Komisioni në datën 20.2.2020.

10. Me vendimin e datës 21.2.2020, me anë të postës elektronike⁵, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Asim Vokshi, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016. Përmes postës elektronike subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 24.2.2020, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i I-rë, Tiranë.

11. Bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Asim Vokshi, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës, si dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

II. SEANCA DËGJIMORE

12. Në datën 24.2.2020 u zhvillua seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit dhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqiti personalisht në seancë.

13. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryer mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove, apo për shpjegime.

¹ E-mail datë 5.2.2020, ora 2:28, “Komisioni – Njoftim për mbylljen e hetimit kryesisht për procesin tuaj të rivlerësimit”.

² E-mail datë 17.2.2020, ora 11:24 – “RE: Komisioni – Njoftim për mbylljen e hetimit kryesisht për procesin tuaj të rivlerësimit”.

³ E-mail datë 20.2.2020, ora 5:40 – “Njoftim vendimi për thirrje dëshmitari”.

⁴ E-mail datë 21.2.2020, ora 14:28 – “Njoftim për denoncim shtesë administruar datë 20.2.2020”.

⁵ E-mail datë 21.2.2020, ora 14:34 – “Njoftim për denoncim shtesë administruar datë 20.2.2020”.

14. Z. Asim Vokshi, pasi dëgjoi relacionin, shprehu qëndrimin e vet, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.

15. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi ta konsiderojë të plotësuar procesin e rivlerësimit për subjektin Asim Vokshi, duke u bazuar mbi të tria kriteret e rivlerësimit.

16. Seanca dëgjimore e datës 24.2.2020 u ndërpre, për të rifilluar në datën 28.2.2020, për shpalljen e vendimit.

17. Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 24.2.2020, subjekti i rivlerësimit, z. Asim Vokshi, kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

18. Subjekti i rivlerësimit, z. Asim Vokshi, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

19. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Sipas kreut IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”:

- i. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror.
- ii. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjekti të rivlerësimit.
- iii. KLGJ-ja është organi përkatës i vlerësimit profesional, i cili në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

20. Referuar vendimit nr. 2/2017⁶, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli

⁶ Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2, të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe

dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

21. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Asim Vokshi, i cili është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2006, me nr. indeksi *** dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

22. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2006 deri në vitin 2016 dhe në datën 23.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar “Deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar, Vetting”. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, është konstatuar:

- a. *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin dhe ka refuzim për deklarim;*
- b. *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- c. *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- d. *ka kryer deklarim të rremë;*
- e. *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

23. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, Vetting”, të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI, nga viti 2006 deri në 2016; (ç) provat shpresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, e në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

24. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii)

kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1, të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, rezultojnë se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

Personat e lidhur, apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit që janë hetuar

25. Për efekt të procesit të rivlerësimit, personat që janë hetuar si të lidhur, apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, janë si më poshtë vijon:

25.1 J.R., bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit – konsiderohet person i lidhur.

25.2 A. dhe H.V. (prindërit e subjekti) – konsiderohen persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, si rezultat i bashkëjetesës dhe dhurimit të apartamentit të ndodhur në Selitë.

25.3 A.V. (vëllai i subjekti) – konsiderohet person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit, si rezultat i dhurimit të automjetit tip “Mercedes Benz”.

Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë “Vetting” të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur

1. Apartament 1+1, me sip. 43 m², ndodhur në *, Tiranë**

Faktet nga hetimi administrativ kryesisht, shpjegimet dhe provat e subjektit në përgjigje të barrës së provës si dhe seanca dëgjimore

1.1. Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron apartament 1+1, me sip. 43 m², ndodhur në ***, Tiranë. Çmimi: 21.350 euro. Pjesa takuese: 100 %. Si burim krijimi subjekti deklaroi: dhuruar nga prindërit (sipas kontratës së dhurimit nr. ***, datë 23.12.2011), të cilët e kanë blerë me kursimet e jetës, sipas dokumenteve (kontrata shitje nr. ***, datë 20.1.2011; vërtetim nr. ***, datë 1.12.2016; vërtetim nr. ***, datë 1.12.2016; deklaratë nr. ***, datë 1.12.2016; kontratë nr. ***, datë 30.5.2000; kontratë nr. ***, datë 26.7.1994; vërtetim pagash të babait për vitet 1994 – 2009, etj.).

1.2. Subjekti, për vërtetimin e deklarimeve të tij, ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁷.

1.3. Në lidhje me përputhshmërinë e deklaramit – nga dokumentacioni i administruar nga ZVRPP-ja Tiranë⁸ konfirmohet se në emër të subjektit të rivlerësimit është regjistruar pasuria e llojit apartament, me sip. 43 m², me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***.

1.4. Nga sa më lart, Komisioni konstaton se përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit.

⁷ Certifikatë pronësie nr. ***, për apartamentin me sip. 43 m², në ***, Tiranë, në emër të Asim Vokshi; kontratë dhurimi pasurie nr. ***, datë 23.12.2011, dhurues A. dhe H.V. dhe pranues dhurimi Asim Vokshi; kontratë shitje nr. ***, datë 20.1.2011, me blerës A. dhe H.V., të apartamentit me sip. 43 m², në vlerën 21.350 euro.

⁸ Shkresa nr. *** prot., datë 25.1.2019, praktika bashkëlidhur.

1.5. Në DPV-në e vitit 2011 subjekti ka deklaruar se zotëron apartament 1+1, me sip. 43 m², ndodhur në ***, Tiranë. Çmimi: 21.350 euro, dhuruar nga prindërit.

1.6. Në deklaratën “Vetting”, në seksionin e të dhënave konfidenciale, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron apartament 1+1, me sip. 43 m², i ndodhur në ***, Tiranë, sipas certifikatës së pronësisë nr. *** – fituar pronësia me kontratën e dhurimit nr. ***, datë 23.12.2011. Dhuruesit e apartamentit janë prindërit e subjektit, A. dhe H.V. dhe burimi i fitimit të kësaj pasurie prej tyre janë kursimet e një jetë të ardhura nga paga, pensioni, shitja e pronave të tjera të paluajtshme, trashëgimia, etj.

1.7. Personat e tjerë të lidhur, A. dhe H.V., me kontratën e shitjes nr. ***, datë 20.1.2011, kanë blerë apartamentin në vlerën 21.350 euro, shumë kjo e likuiduar jashtë zyrës noteriale. Ky apartament i është dhuruar subjekti të rivlerësimit brenda të njëjtit vit.

1.8. Në lidhje me analizimin e mjaftueshmërisë dhe ligjshmërisë së burimit të krijimit nga personat e tjerë të lidhur/dhuruesit, Komisioni konstaton se:

1.9. Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017 subjekti ka deklaruar si burim krijimi dhurimin nga prindërit, sipas kontratës së dhurimit nr. ***, datë 23.12.2011. Subjekti deklaron se prindërit kanë përdorur si burim krijimi për blerjen e këtij apartamenti kursimet e një jete, duke përfshirë të ardhurat nga paga, pensioni, shitja e pronave të tjera të paluajtshme, trashëgimia, etj.

1.10. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti deklaron se burimi i dhuratës që i kanë bërë prindërit janë kursimet e një jete punë, nga të ardhurat që kanë pasur nga puna në pozicione publike dhe private, duke sqaruar më tej se të ardhurat e prindërve ndër vite vijnë nga pagat, pensionet, dietat dhe udhëtimet jashtë shtetit të babait në vitet ‘90, puna private, trashëgimia, shitja e pronave të paluajtshme dhe të luajtshme, etj.

1.11. Bazuar në këtë deklaram të subjektit të rivlerësimit, vërehet se këto burime përbëhen nga:

a. Të ardhura të krijuara nga punësimi dhe pensionet

1.12. Të ardhura nga pagat dhe pensionet për periudhën 1994 – 2010, për personat e tjerë të lidhur, A. dhe H.V., rezultojnë në shumën 6.139.694 lekë, vërtetuar me dokumentacionin e dorëzuar⁹ nga subjekti i rivlerësimit dhe atij të siguruar nga Komisioni¹⁰.

1.13. Ndërkohë që, në lidhje me të ardhurat në shumën 300.000 lekë pranë shoqërive private “****” sh.p.k., dhe “****”, në shumën 900.000 lekë, Komisioni nuk i ka marrë në konsideratë, për shkak se: (i) në lidhje me të ardhurat nga shoqëria “****” sh.p.k. – nuk ka dokumentacion ligjor justifikues për burimin nga puna e kryer pranë kësaj shoqërie. Dega e Arkivit Qendror

⁹ Dosja e ILDKPKI-së: vërtetim nr. ***, datë 1.12.2016, nga ISSH; vërtetim nr. ***, datë 1.12.2016, nga ISSH; vërtetim page nga Drejtoria e Policisë Lezhë; vërtetim page nga Drejtoria e Policisë Gjirokastrë; vërtetim page nga Drejtoria e Policisë Durrës; vërtetim page nga Drejtoria e Policisë Elbasan; vërtetim page nga Drejtoria e Policisë Berat; vërtetim page nga Drejtoria e Policisë Shkodër; vërtetim page nga Drejtoria e Policisë Tiranë; vërtetim page nga Komisariati Policisë Krujë, për z. A.V.; vërtetim page nga Drejtoria e Policisë Dibër; vërtetim page nga Drejtoria e Policisë Lezhë; vërtetim page nga Drejtoria e Policisë Tiranë, datë 10.8.2016.

¹⁰ Shkresë nr. ***, datë 10.10.2019, e ISSH-së.

Lundër, në përgjigje¹¹ të kërkesës së Komisionit, shprehet se nuk disponon listëpagesa për shoqërinë “***” sh.p.k., për periudhën e punësimit (1.3.2008 – 1.4.2009) të deklaruar nga personi tjetër i lidhur, A.V. Gjithashtu, nga kërkitimi *online* në faqen zyrtare të QKB-së, konstatohet se shoqëria “***” sh.p.k., është pezulluar në datën 30.1.2009; (ii) në lidhje me të ardhurat nga shoqëria “***” sh.p.k., – nuk ka dokumentacion ligjor justifikues për burimin nga puna e kryer pranë kësaj shoqërie. Dega e Arkivit Qendror Lundër shpjegon se emri i personit tjetër të lidhur, A.V., nuk figuron në listëpagesat që disponohen nga arkivi¹². Ndërkohë që subjekti ka depozituar një kontratë pune¹³, e cila daton më vonë se data e blerjes së apartamentit.

b. Të ardhura të krijuara nga aktiviteti privat

1.14. Në shtesë të deklarimeve të bëra në deklaratën “Vetting”, subjekti, në përgjigje të pyetësorit standard, deklaroi se familja e tij është marrë me aktivitet privat shitje me shumicë dhe pakicë të artikujve të ndryshëm industrialë, fillimisht në qytetin e Lezhës dhe më pas në qytetin e Shkodrës (gusht 1994 – shtator 1997). Ky aktivitet privat ka qenë intensiv dhe ka gjeneruar të ardhura të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e jetesës dhe për të pasur kursimet e nevojshme për të ardhmen (rreth 5.000.000 lekë). Sipas subjektit, aktiviteti privat është ushtruar sipas ligjeve të kohës, duke paguar të gjitha detyrimet tatimore në shtet, por që për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar dhe mospasjes së detyrimit për të ruajtur dokumentacionin, fatkeqësisht nuk disponohet sot.

1.15. Komisioni kërkoi informacion pranë drejtorive rajonale të Lezhës dhe Shkodrës, të cilat në përgjigjet¹⁴ e tyre informojnë se personat e tjerë të lidhur, A. dhe H.V., nuk rezultojnë të regjistruar për ushtrim aktiviteti privat.

c. Të ardhura të krijuara nga trashëgimia

1.16. Në shtesë të deklarimeve të bëra në deklaratën “Vetting”, subjekti, në përgjigje të pyetësorit standard, deklaroi se në vitet 1999 – 2001, babai i tij, personi tjetër i lidhur, A.V., ka qenë përfitues i të ardhurave nga trashëgimia e babait të tij në Kosovë, e cila është marrë në dorëzim fillimisht nga i vëllai A.V., dhe i është dorëzuar më pas personit tjetër të lidhur, A.V. në *cash*. Vlera e trashëgimisë është rreth 40.000 marka gjermane. Për të vërtetuar këtë, subjekti ka dorëzuar një deklaratë, lëshuar nga A.V., vëllai i personit tjetër të lidhur, A.V. (deklaratë shkresore pa datë dhe nuk është e përpiluar pranë noterit).

1.17. Në pyetësorin nr. 2 Komisioni i ka kërkuar subjektit të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues për trashëgiminë e përfitur nga babai, personi tjetër i lidhur, A.V.

1.18. Subjekti, në përgjigje, deklaroi se xhaxhai i tij, A.V., pas vitit 1991, së bashku me përfaqësues të trungut familjar të vëllezërve të gjyshit të tij (i ardhur nga Kosova para vitit 1944), kanë shkuar herë pas here në Kosovë, për të identifikuar pasuritë e paluajtshme që ka

¹¹ Shkresë nr. *** prot., datë 8.10.2019.

¹² Disponohen listëpagesa për periudhën mars, prill, shtator - tetor 2009, janar 2010, ndërsa për periudhën mars 2008 - shkurt 2009, maj - gusht 2009, shkurt 2010 - dhjetor 2011 nuk administrojnë listëpagesa.

¹³ Kontrate pune date 15.2.2012.

¹⁴ Shkresë nr. ***, datë 17.10.2019, Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër; shkresë nr. ***, datë 15.10.2019, Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë.

pasur në bashkëpronësi gjyshi dhe vëllezërit e tij. Nga viti 1992 deri në vitin 1997 xhaxhai i subjektit ka arritur që nëpërmjet dëshmitarëve të ndryshëm në Kosovë, me pleqësi dhe sipas zakoneve të atjeshme, të identifikojë pronat e lëna nga i ati, të cilat ishin mbajtur në përdorim për shumë vite me radhë nga të afërm apo bashkëfshatarë të tjerë. Duke filluar nga viti 1999 deri në vitin 2001, xhaxhai i subjektit, A.V., ka arritur me mirëkuptim të marrë vlerën e pasurive të lëna në trashëgimi nga gjyshi i subjektit, M.D.V., dhe t'i japë edhe vëllezërve të tij pjesën e tyre. Për shkak të luftës në Kosovë dhe shkatërrimit të një pjese të dokumentacionit, xhaxhai i subjektit është marrë vesh me zotëruesit e tokave dhe të pasurive të tjera të paluajtshme në Kosovë që të bënin pagesat e vlerës së pasurive. Marrëveshjet janë arritur në mirëbesim dhe sipas zakoneve, bazuar në faktin se banorët e zonës që zotëronin pronat, e dinin pronësinë e vjetër të tyre.

1.19. Më tej, subjekti deklaroi se personi tjetër i lidhur, A.V., nuk ka qenë palë negociuese, por është përfaqësuar nga i vëllai i tij A.V., i cili i ka lëshuar edhe deklaratën me shkrim për sa i ka dhënë nga trashëgimia e babait të tyre në Kosovë (vlera rreth 40.000 marka gjermane). Subjekti deklaroi se xhaxhai i tij, A.V., është dëshmitar i marrjes së vlerës monetare të trashëgimisë së lënë nga gjyshi i subjektit në Kosovë.

1.20. Si prova rrethore subjekti ka paraqitur dëshminë e trashëgimisë së të ndjerit M.D.V. (gjyshi i subjektit), e lëshuar me vendimin nr. ***, datë 26.3.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, si dhe certifikata familjare nr. ***, datë 27.4.2016, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Rrethi Shkodër.

d. Të ardhura të krijuara nga shitblerja e pasurive të paluajtshme

1.21. Në shtesë të deklarimeve të bëra në deklaratën “Vetting, subjekti, në përgjigje të pyetësorit standard, deklaroi se të ardhurat e përfituara nga puna dhe trashëgimia, prindërit e tij i kanë investuar herë pas here në pasuri të paluajtshme, si dhe, sipas nevojës, i kanë konvertuar edhe në valuta të ndryshme, ose i kanë dhënë hua. Sipas subjektit, kursimet në para, për shkak të tranzicionit që ka kaluar Shqipëria, prindërit e tij i kanë mbajtur në formën *cash*, duke qenë mosbesues ndaj sigurisë së sistemit bankar.

1.22. Në deklaratën “Vetting” dhe në pyetësorin standard subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar 4 kontrata të shitblerjeve të pasurive të paluajtshme¹⁵ dhe pretendon se ka fituar një shumë prej 3.427.039 lekësh nga shitja e këtyre pasurive.

1.23. Me qëllim përcaktimin e fitimit neto nga shitja e këtyre pasurive të paluajtshme, Komisioni iu drejtua Agjencisë Shtetërore të Kadastrës¹⁶ dhe noterëve¹⁷ pranë të cilëve janë kryer transaksionet e pronave të referuara më sipër.

1.24. Nga hetimi i dokumentacionit të administruar gjatë hetimit rezultoi se lidhur me pasurinë tokë pemëtore, me sip. 1210 m², truall me sip. 200 m², si dhe një banesë me sip. 120

¹⁵ (1) Kontratë shitblerje shtëpi banimi, ndodhur në qytetin e Shkodrës, në vlerën 400.000 lekë; (2) kontratë shitblerje banese, ndodhur në qytetin e Lezhës, në vlerën 1.100.000 lekë; (3) kontratë shitblerje tokë pemëtore, truall, ndërtesë në Larushk, Krujë, në vlerën takuese 1.316.250 lekë; (4) kontratë shitblerje arë në Tapizë, Krujë në vlerën takuese 6.375 dollarë.

¹⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 9.10.2019.

¹⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 9.10.2019; nr. *** prot., datë 9.10.2019; nr. *** prot., datë 9.10.2019; nr. *** prot., datë 9.10.2019, nr. *** prot., datë 9.10.2019; nr. *** prot., datë 22.10.2019; nr.*** prot., datë 1.11.2019.

m^2 ¹⁸, ndodhur në fshatin Larushk, Krujë, konstatohet se: (i) fillimisht kjo pasuri është blerë nga personi tjetër i lidhur, A.V., bashkë me shtetasin M.P. nga shitësit L.M. dhe B.M., me anë të kontratës së shitblerjes tokë pemëtoje, truall dhe ndërtesë nr. ***, datë 30.6.2003, në vlerën 20.000 dollarë; (ii) ndërkohë që, në datën 1.12.2009, po të njëjtën pasuri të blerë më lart, personi tjetër i lidhur, A.V., bashkë me shtetasin M.P., ia shesin përsëri z. L.M. për një shumë prej 5.265.000 lekësh. Nga analizimi i këtyre dy transaksioneve konstatohet se palët janë në një kontratë blerëse dhe në tjetrën shitëse dhe se çmimi i shitjes në vitin 2009 (ose kthimi mbrapsht) është afërsisht dyfish më i lartë se ai i blerjes.

1.25. Lidhur me pasurinë tokë arë, me sip. 3.400 m² ¹⁹, ndodhur në Tapizë, Krujë, referuar praktikës së administruar nga zyra noteriale e z. S.Sh.M., rezulton se:

1.26. Sipas praktikës noteriale rezulton se kjo pasuri është blerë nga personi tjetër i lidhur, A.V., bashkë me shtetasin M.P., me anë të kontratës së shitblerjes tokë bujqësore nr. ***, datë 14.10.2003, në vlerën 25.000 dollarë, në pjesët përkatëse: ¼ i takon personit tjetër të lidhur, A.V., dhe ¾ shtetasit M.P.

1.27. Në datën 4.12.2009 është lidhur akti noterial nr. ***, ndërmjet shitësve M.P., A.V., H.V. dhe blerësve I.K. dhe A.Xh. Kjo pasuri është shitur në vlerën totale 25.500 dollarë, pra, personit tjetër të lidhur, A.V., i korrespondon vlera prej 6.375 dollarë, ¼ e pjesës së tij të bashkëpronësisë në pasurinë e paluajtshme.

1.28. Lidhur me pasurinë shtëpi banimi, me sip. 235 m², ndodhur në qytetin e Shkodrës, referuar dokumentacionit të administruar nga ZVRPP-ja Shkodër²⁰ dhe praktikës së administruar nga zyra noteriale e znj. A.A., rezulton se personi tjetër i lidhur, A.V., ka pasur në pronësi pasurinë me nr. ***, me sip. 235 m², nga të cilat 91 m² janë ndërtesë. Kjo pasuri është blerë në datën 21.4.1974, me vlerë 29.000 lekë. Personi tjetër i lidhur, A.V., e ka shitur këtë pasuri me kontratën nr. ***, datë 30.5.2000, në vlerën 400.000 lekë.

1.29. Lidhur me pasurinë apartament me sip. 55.82 m², ndodhur në lagjen “****”, Lezhë, referuar dokumentacionit të administruar nga ZVRPP-ja Shkodër²¹, rezulton se personi tjetër i lidhur, A.V., e ka përfutur këtë apartament me anë të kontratës së privatizimit, datë 23.8.1993, në vlerën 10.314 lekë. Më tej, me anë të kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 26.7.1994, personi tjetër i lidhur, A.V., e ka shitur në vlerën 1.100.000 lekë.

1.30. Në pyetësin nr. 3 subjektit të rivlerësimit iu kërkua të paraqesë dosjen e plotë, ku të evidentohet çdo tjetërsim, origjina dhe historiku i pasurive apartament banimi në qytetet Shkodër dhe Lezhë.

1.31. Në përgjigje të pyetësit, subjekti deklaroi se babai i tij, personi tjetër i lidhur, A.V., është zhveshur nga pronësia mbi pasuritë e mësipërme, duke mos gëzuar më cilësinë e pronarit

¹⁸ Kjo pasuri ka këto të dhëna: nr. pasurie ***, z. k. ***, me indeks të hartës ***, regjistruar vol. ***, f. ***, me nr. doc. ***.

¹⁹ Kjo pasuri ka këto të dhëna: nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***.

²⁰ Shkresa nr. *** prot., datë 8.11.2019.

²¹ Shkresa nr. *** prot., datë 30.1.2020.

– ai nuk ka të drejtë ligjore të kërkojë dosjen e regjistrimit të këtyre pasurive, të cilat ndodhen të depozituara në degët përkatëse rajonale të ASHK-ve Shkodër dhe Lezhë.

1.32. Më tej, subjekti deklaron se shtëpia e banimit në qytetin e Shkodrës është blerë nga personi tjetër i lidhur, A.V., në vitin 1975, me kursimet e familjes së tij, në të cilën ka jetuar familja e babait të subjektit deri në vitin 2000, kur është realizuar kontrata e shitjes. Kjo shtëpi ka qenë e peregjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme, ndonëse ishte shtëpi shumë e vjetër. Regjistrimi në vitin 2000 (para shitjes) është bërë në bazë të nenit 24/b, të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar me ligjin nr. 8090, datë 21.3.1996.

1.33. Lidhur me apartamentin e ndodhur në qytetin e Lezhës, subjekti sqaroi se ky apartament është privatizuar sipas ligjeve të kohës nga personi tjetër i lidhur, A.V., në cilësinë e sipërmarrësit. Përveç kontratës së shitjes, ai nuk disponon ndonjë dokument tjetër, pasi janë depozituar pranë ASHK-së Lezhë.

e. Lidhur me godinën 3-katëshe në ish-pronësi të personit tjetër të lidhur, A.V., ndodhur në rrugën “**”, Tiranë**

1.34. Referuar raportit dhe dokumentacionit të administruar nga ILDKPKI-ja²² rezulton se në emër të z. A.V. është e regjistruar pasuria e llojit truall, me sip. 673 m² dhe ndërtesë me sip. 120 m² (pasuri aktive), përfituar me kontratë shitblerje nr. ***, datë 6.12.2000, në vlerën 2.000.000 lekë, me blerës A.V. dhe M.P.

1.35. Referuar sa më sipër, ILDKPKI-ja ka konstatuar se: (i) blerja e truallit me sip. 673 m², e ndërtesës me sip. 420 m² dhe e zonës në të cilën ndodhet objekti në vlerën 2.000.000 lekë është vlerë anomalisht e ulët dhe çmim fiktiv, me qëllim fshehjen e burimit financiar që ka shërbyer për blerjen e tij; (ii) referuar objektit 3-katësh, gjykohet që vlera e mobilimit të jetë e konsiderueshme dhe, si rrjedhojë, ka mungesë burimi financiar të ligjshëm për këto shpenzime; (iii) referuar fotove të objektit, konstatohet se ndërtimi është bashkëkohor dhe vihet re se në të janë kryer shpenzime rikonstruksioni të kohëve të fundit, shpenzime të cilat tregojnë qartë, se vlera e kësaj banese është shumë herë më e madhe se ajo e cituar në kontratën e blerjes në vitin 2000; (iv) mungojnë burimet financiare të ligjshme për blerjen, rikonstruksionet e kryera dhe për mobilimin e objektit 3-katësh nga prindërit e subjektit, çka krijon bindjen se të ardhurat e përdorura të jenë të subjektit të rivlerësimit dhe njëkohësisht rezultojnë të jenë fshehur prej tij.

1.36. Komisioni hetoi lidhur me pasuritë e paluajtshme që figurojnë aktualisht të regjistruara apo të transkriptuara në emër të personit tjetër të lidhur, A.V.

²² Shkresa nr. ***, datë 27.3.2018, e ZVRPP-së, bashkëlidhur vërtetimi hipotekor nr. ***, datë 8.9.2000, në emër të shtetasit P.H., për truall me sip. 673 m² dhe banesë 3-katëshe me sip. totale 420 m²; kontratë shitblerje nr. ***, datë 6.12.2000, me shitës P.H. dhe blerës M.P. dhe A.V., për banesë 3-katëshe, me sip. totale ndërtimi 420 m² dhe truall me sip. 673 m², në vlerën 2.000.000 lekë; aplikim për regjistrim date 7.12.2000, nga shtetasi M.P., për banesë 3-katëshe, me sip. ndërtimi 420 m² dhe truall me sip. 673 m²; kartelë pasurie, për pasurinë ndërtesë me sip. 120 m², me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, në vlerën 2.000.000 lekë; fotografi të banesës 3-katëshe + hartë treguese.

1.37. Nga dokumentacioni i administruar nga ZVRPP-ja Tiranë²³ konfirmohet se në emër të personit tjetër të lidhur, A.V., ka qenë e regjistruar pasuria e llojit truall, me sip. 673 m², me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. *** (hapur kartela si ndërtesë me sip. 118 m²), ndërkohë, sipas sistemit hipotekor dhe kontratës së shitjes pasuria është e llojit truall me sip. 673 m² (pasuri e transkriptuar).

1.38. Bashkëlidhur praktikës gjendet e administruar kontrata e shitjes nr. ***, datë 6.2.2001, me palë shitëse personin tjetër të lidhur, A.V. dhe shtetasin M.P. dhe palë blerëse E.T.; si dhe kartela e pasurisë datë 11.01.2019, ku kjo pronë figuron e regjistruar në emër të z. E.T.

1.39. Për sa rezultoi sa më sipër, Komisioni iu drejtua përsëri ASHK-së, ku kërkoi të vihet në dispozicion dosja e plotë e kësaj pasurie dhe të evidentohet çdo tjetërsim dhe historiku i kësaj prone.

1.40. Nga dokumentacioni i administruar nga ZVRPP-ja Tiranë²⁴ bëhet me dije se pavarësisht përshkrimit në kontratën e shitjes nr. ***, datë 6.12.2000, me palë blerëse M.P. dhe A.V., si dhe kontratës së shitjes nr. ***, datë 6.2.2001, me palë blerëse E.T., origjina e pronës nuk ka dokument ligjor për sipërfaqe trualli, por vetëm për ndërtesë. Zyra pajis me dokument pronësie vetëm kur faktet vërtetohen me dokument pronësie.

1.41. Referuar praktikës së përcjellë nga ZVRPP-ja, personi tjetër i lidhur, A.V., dhe shtetasi M.P., me anë të kontratës së shitjes nr. ***, datë 6.12.2000, e kanë blerë këtë pasuri në vlerën 2.000.000 lekë.

1.42. Më tej, me kontratën e shitjes nr. ***, datë 6.2.2001, personi tjetër i lidhur, A.V. dhe shtetasi M.P. e kanë shitur këtë pasuri në vlerën 50.000 DM. Kjo vërtetohet edhe me kontratën e pasurisë, sipas së cilës kjo pronë figuron në emër të z. E.T.

1.43. Për të hetuar me tej lidhur me këtë pasuri, Komisioni i është drejtuar përsëri ASHK-së të informojë lidhur me historikun e regjistrimit të kësaj pasurie: a ka pasur vonesa në regjistrimin e saj nga shtetasi E.R.T. dhe nëse po, të vihen në dispozicion dokumentet provuese të penaliteteve që janë aplikuar.

1.44. Nga dokumentacioni i administruar nga ZVRPP-ja Tiranë²⁵ konfirmohet se kjo pasuri figuron e regjistruar në emër të z. E.T., regjistruar në datën 7.1.2019. Në praktikën bashkëlidhur gjendet e administruar shkresa datë 14.4.2015, e ZVRPP-së Tiranë, me lëndë “kërkesë për plotësim dokumentacioni”, drejtuar z. E.T., ku i bëhet me dije dokumentacioni që duhet të dorëzojë për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme. Më tej, në dosje gjendet e administruar kërkesa e datës 27.12.2019, e z. E.T., i cili kërkon informacion lidhur me regjistrimin e objektit në emër të tij.

1.45. Nga hetimi rezultoi se kontrata e blerjes dhe e shitjes së kësaj prone është lidhur pranë noteres R.S., e cila nuk e ushtron më këtë profesion. Në këto kushte, Komisioni i është drejtuar Dhomës Kombëtare të Noterëve, për të informuar pranë cilit noter janë administruar arkivat e

²³ Shkresa nr. ***prot., date 25.1.2018.

²⁴ Shkresa nr. ***prot., datë 4.11.2019.

²⁵ Shkresa nr. ***prot., datë 26.12.2019.

noteres R.S., lidhur me aktet noteriale të nënshkuara prej zyrës së saj noteriale në vitet 2000 dhe 2001.

1.46. Nga dokumentacioni i administruar nga zyra noteriale e znj. E.S.H.²⁶ konfirmohet lidhja e kontratave nr. ***, datë 6.12.2000 dhe nr. ***, datë 6.2.2001, shoqëruar me praktikën bashkëlidhur.

1.47. Më tej, Komisioni ka kërkuar nga OSHEE-ja dhe UKT-ja dosjen e plotë/kontratat, datat e lidhjes, ku të evidentohet qartë historiku i pagesave dhe subjekti që i ka kryer ato, lidhur me objektin në pronësi të shtetasit E.R.T., i datëlindjes 15.9.1945, ID ***, ndodhur në rrugën “****”, Tiranë.

1.48. Nga dokumentacioni i administruar nga UKT-ja Tiranë²⁷ rezultoi se shtetasi E.T. ka aplikuar për hapje kontrate me shoqërinë UKT, për objektin me adresë: rruga “****” (ish-rruga “****”) në datën 30.9.2011. Bashkëlidhur praktikës gjendet i administruar në dosje edhe vetëdeklarimi i këtij shtetasi për legalizimin e objektit, i cili mban datën 20.7.2006.

1.49. Nga dokumentacioni i administruar nga OSHEE-ja Tiranë²⁸ rezultoi se me gjeneralitetet e shtetasit E.R.T. identifikohet një abonent²⁹ në adresën “****”, Tiranë, i cili figuron i regjistruar prej prillit të vitit 2007. OSHEE-ja nuk disponon kopje të kontratave para vitit 2007, pasi ky shërbim asokohe menaxhohej nga KESH sh.a. (në datën 5.6.2018 është bërë ndryshimi i emrit të kontratës nga abonenti U.T. në E.T.).

1.50. Nga hetimi i Komisionit rezultoi se referuar regjistrin *online* të gjendjes civile të vitit 2008, shtetasi E.T. figuron me adresë banimi në rrugën “****”, Tiranë, që përkon me adresën e kësaj prone (ndërkohë, në momentin e lidhjes së kontratës në vitin 2001 figuronte me adresë banimi në rrugën “****”, p. ***, ap. ***, Tiranë).

1.51. Për të konfirmuar këtë fakt, Komisioni i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, për të vërtetuar adresën e saktë të banimit/rezidencën e shtetasit E.R.T., prej muajit janar të vitit 2001 deri në ditët e sotme.

1.52. Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile³⁰ informon se ky shtetas figuron i regjistruar në zyrën e gjendjes civile në Njësinë Bashkiake nr. ***, “****” Tiranë, me referencë ***. Familja e shtetasit E.T. është vendosur në këtë njësi në datën 11.2.2005, me transferim nga ish-Njësia Bashkiake nr. ***, “****”, Tiranë, me referencë *** (në këtë njësi rezultonte që nga data 1.6.2000).

1.53. Kjo pasuri figuron e regjistruar në emër të shtetasit E.T., përfituar me kontratën e shitjes nr. ***, datë 6.2.2001, me palë shitëse personi tjetër i lidhur, A.V., dhe shtetasi M.P. dhe palë blerëse E.T.

f. Pasuri të tjera në emër të personit tjetër të lidhur, A.V.

²⁶ Shkresa datë 27.11.2019, praktika bashkëlidhur.

²⁷ Shkresa nr. ***prot., datë 9.12.2019.

²⁸ Shkresa nr. *** prot., datë 11.12.2019.

²⁹ Me kontratë furnizimi nr. ***.

³⁰ Shkresa nr. ***prot., datë 6.12.2019.

1.54. Nga dokumentacioni i administruar nga ZVRPP-ja Tiranë³¹ bëhet e ditur se në emër të personit tjetër të lidhur, A.V., është e regjistruar pasuria e paluajtshme e llojit apartament me sip. 57.41 m² (pasuri aktive), me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e ndodhur në ***, Tiranë, e cila sipas kartelës së pasurisë bashkëlidhur është regjistruar në datën 23.9.2019.

1.55. Kjo pasuri është përftuar me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 30.9.2019, me palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k., dhe blerës A. dhe H.V., në vlerën 26.400 euro.

1.56. Referuar kontratës, çmimi i shitjes është likuiduar midis palëve sipas kontratës së porosisë nr. ***, datë 16.1.2007.

1.57. Më konkretisht, pagesat e kësteve të apartamentit janë bërë si vijon: (i) shuma prej 13.200 euro do të paguhej menjëherë pas nënshkrimit të kontratës – sipas vërtetimit bashkëlidhur praktikës rezulton të jetë paguar në datën 16.1.2007; (ii) shuma prej 11.000 euro do të paguhej brenda qershorit të vitit 2007 – sipas vërtetimit bashkëlidhur praktikës rezulton të jetë paguar në datën 28.6.2007; (iii) shuma prej 2.200 euro do të paguhej në momentin e përfundimit të apartamentit – sipas vërtetimit bashkëlidhur praktikës rezulton të jetë paguar në datën 30.11.2009.

1.58. Nga dokumentacioni i administruar rezultuan shitblerjet e pasurive të paluajtshme³², si më poshtë:

Përshkrim	Çmim blerje	Çmim shitje	Diferenca
Banesë nr. ***, Lezhë	0 ³³	1,100,000	1,100,000
Shtëpi me sip. 235 m ² , Shkodër	0 ³⁴	400,000	400,000
Pemëtore (1.210 m ²), truall (200 m ²), ndërtesë (120 m ²), Krujë	543,450	1,316,250	772,800
Arë (me sip. 3.400 m ²), në ***, Krujë	679,313	610,789	- 68,524
Truall (673 m ²), ndërtesë ***-katëshe (kati *** 120 m ² , kati *** 150 m ²)	1,000,000	1,684,500	684,500
TOTAL	2,222,763	5,111,539	2,888,776

1.59. Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e personave të tjerë të lidhur, A. dhe H.V., të paraqitura si më poshtë:

Përshkrim	Të deklaruara nga subjekti	Të justifikuara me dokumentacion ligjor
Të ardhura nga pagat dhe pensionet 1994 – 31.12.2010	6,139,694	6,139,694
Të ardhura nga punësimi pranë “****” sh.p.k.	300,000	-
Të ardhura nga punësimi pranë “****” sh.p.k.	900,000	-

³¹ Shkresa nr. *** prot., datë 29.10.2019.

³² Në tabelë nuk janë përfshirë pasuritë në pronësi aktuale të personave të tjerë të lidhur, A.V. dhe H.V.

³³ Është konsideruar vlerë 0, pasi kjo pasuri është blerë në vlerën 10.314 lekë, në datën 23.8.1993, periudhë e cila nuk është e përfshirë në analizë dhe për të cilën nuk janë llogaritur as të ardhurat.

³⁴ Është konsideruar vlerë 0, pasi kjo pasuri është blerë në vlerën 29.000 lekë, në datën 21.4.1975, periudhë e cila nuk është e përfshirë në analizë dhe për të cilën nuk janë llogaritur as të ardhurat.

Të ardhura nga trashëgimia e babait 1999 – 2001 (40.000 dem)	2,469,200	-
Të ardhura nga aktiviteti privat tregti artikuj industrialë	5,000,000	-
Të ardhura nga shitblerja e pasurive të paluajtshme	2,204,276	2,888,776
Total të ardhura	17,013,170	9,028,470
Shpenzime jetike ³⁵		4,160,568
Blerë apartament 80 m ² , ***, pallatet ***, Tiranë, në pronësi		3,155,263
Pagesë kësti 13.200 euro për ap. 57.41 m ² , Tiranë, në pronësi ³⁶		1,607,496
Pagesë kësti 11.000 euro për ap. 57.41 m ² , Tiranë, në pronësi ³⁷		1,339,580
Pagesë kësti 2.200 euro për ap. 57.41 m ² , Tiranë, në pronësi ³⁸		303,512
Blerë apartamenti 43 m ² , dhuruar subjektit		3,000,000
Total shpenzime		13,566,420
Diferenca		- 4,537,949

Kalimi i barrës së provës nga hetimi administrativ kryesisht

1.60. Në lidhje me apartamentin e dhuruar nga prindërit – nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se:

1.61. Për të ardhurat nga e krijuara nga punësimi dhe pensionet – mungon dokumentacioni ligjor justifikues në lidhje me të ardhurat e përfituara nga personi tjetër i lidhur, A.V., për shumën prej 1.200.000 lekësh (900.000 + 300.000).

1.62. Për të ardhurat nga aktiviteti privat – mungon dokumentacioni ligjor justifikues në lidhje me burimin e krijimit dhe ligjshmërisë së të ardhurave të përfituara nga personat e tjerë të lidhur, A. dhe H.V., për shumën prej 5.000.000 lekësh.

1.63. Për të ardhurat nga trashëgimia – mungon dokumentacioni ligjor justifikues në lidhje me burimin e krijimit dhe ligjshmërinë e të ardhurave të përfituara nga personi tjetër i lidhur, A.V., për shumën prej 2.469.200 lekësh (40.000 marka gjermane), për të provuar deklaratimet e subjektit.

1.64. Për të ardhurat e krijuara nga shitblerja e pasurive të paluajtshme – duket i dyshimtë fakti që personi tjetër i lidhur, A.V., dhe shtetasi M.P. ia kanë shitur këtë pronë blerësit, i cili figuron shitësi/pronari i mëparshëm i kësaj pasurie, si dhe rezulton e shitur prej tyre në vlerë pothuaj dyfish më të lartë.

³⁵ Përllogaritja e shpenzime jetike: (1) në masën 80% të të ardhurave për periudhën 1994 – 1996 (4 persona); (2) në masën 5.000 lekë/muaj personi për periudhën 1997 – 1999 (4 persona); (3) sipas shkresës nr. ***, ILDKPKI, për periudhën 2000 – 2002 (4 persona); për vitin 2003 (3 persona); për periudhën 2004 – 2010 (2 persona), vlera për vitin 2007 e saktësuar sipas shkresës nr. ***, datë 27.5.2008, së INSTAT-it, drejtuar ILDKPKI-së.

³⁶ Kurs këmbimi sipas faqes zyrtare të Bankës së Shqipërisë në datën 31.12.2007.

³⁷ Kursi i këmbimit sipas faqes zyrtare të Bankës së Shqipërisë në datën 31.12.2007.

³⁸ Kursi i këmbimit sipas faqes zyrtare të Bankës së Shqipërisë në datën 31.12.2009.

1.65. Nga analiza financiare për pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet personave të tjerë të lidhur, A. dhe H.V., duket se kanë mungesë të të ardhurave të ligjshme, të shoqëruara me dokumentacion justifikues për blerjen e apartamentit të dhuruar subjektit të rivlerësimit, në vlerën 21.500 euro, blerjen e pasurive në emër të tyre dhe kryerjen e shpenzimeve.

Shpjegimet dhe provat e subjektit të rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës

1.66. *Për të ardhurat e krijuara nga punësimi dhe pensionet – punësimi i babait të subjektit në shoqëritë “***” sh.p.k., dhe “***” sh.p.k.,* për të cilin subjekti shpjegon se si burim për pasurinë e prindërve të tij kanë shërbyer edhe të ardhurat e babait të tij nga punësimi në shoqëritë “****” sh.p.k., dhe “****” sh.p.k. Subjekti sqaron se sipas ligjit nr. 8770, datë 19.4.2001 “Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike”, i ndryshuar, licencimi i shoqërisë së ruajtjes fizike bëhej vetëm pasi ajo të ishte regjistruar në regjistrin tregtar dhe në aktin e themelimit të kishte të përcaktuar edhe drejtuesin teknik (neni 3(2) i ligjit nr. 8770/2001). Drejtuesi teknik kishte detyra të mirëpërcaktuara në ligj dhe ishte ndër funksionarët që duhej të kryente funksione të përditshme për menaxhimin e shërbimeve të sigurisë (nenet 6(2), 11(1), 12(1), 17, etj.), prandaj marrëdhënia e babait të tij me shoqëritë ishte e qëndrueshme, duke u paguar për shërbimin e bërë.

1.67. Për periudhën 1.3.2008 – 1.4.2009 babai i subjektit ka punuar në shoqërinë “****” sh.p.k., si drejtues teknik, çka konfirmohet edhe nga licenca e drejtuesit teknik datë 29.2.2008, e paraqitur më herët prej subjektit si provë.

1.68. Sipas nenit 10, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, i ndryshuar, ishte punëdhënësi ai që kishte detyrimin e mbajtjes së tatimit në burim dhe ta derdhte në organet tatimore.

1.69. Për të provuar më tepër këtë fakt, babai i subjektit ka siguruar edhe një vërtetim datë 7.2.2020, të lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k., të cilin ia bashkëlidh këtyre shpjegimeve³⁹.

1.70. *Në lidhje me punësimin e babait të subjektit në shoqërinë “****” sh.p.k.,* subjekti thekson se sipas ekstraktit të QKR-së datë 2.3.2009, rezulton se me vendim të ortakut të vetëm nr. ***, datë 20.2.2009, z. A.V. është caktuar drejtues teknik i kësaj shoqërie dhe më pas është licencuar me leje të posaçme nr. ***, datë 7.4.2009, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Marrëdhënia e punës pranë kësaj shoqërie nuk është shoqëruar me lidhjen e një kontrate pune me shkrim, e cila në çdo rast, sipas Kodit të Punës, ka qenë detyrim i punëdhënësit.

1.71. Vetëm në vitin 2012, pak para se babai i subjektit të ndërpriste marrëdhënien e punës me këtë shoqëri (për shkak se u rikthye në Policinë e Shtetit), u lidh kontrata e punës me shkrim e datës 15.2.2012, pasi në atë kohë autoritetet shtetërore filluan t’u kërkonin shoqërive të ruajtjes fizike formalizimin me shkrim të marrëdhënieve të punës. Lidhur me pagesën e tatimeve, vlen i njëjti shpjegim si më sipër në lidhje me zbatimin e nenit 10, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, i ndryshuar.

³⁹ Vërtetim datë 7.2.2020, ku shoqëria “****” sh.p.k., konfirmon se shtetasi A.V. ka punuar për llogari të kësaj shoqërie gjatë periudhës 1.3.2008 – 1.4.2009, me pagë mujore 25.000 lekë.

1.72. Subjekti pretendon se provat e paraqitura më herët nga ana e tij⁴⁰ përbëjnë prova të mjaftueshme për këtë fakt.

1.73. *Për të ardhurat nga aktiviteti privat* për periudhën 1994 – 1997 në qytetet Lezhë dhe Shkodër – subjekti deklaroi se përgjigjet negative nga organet tatimore në Lezhë dhe Shkodër, të cilat janë lëshuar pas konsultimit prej këtyre organeve tatimore me sistemin elektronik C@TS, nuk shprehen dhe nuk konfirmojnë se janë të plota dhe shteruese për sa vërtetojnë. Kjo pasi, koha kur është ushtruar aktiviteti tregtar nga babai i tij nuk konfirmohet jashtë çdo dyshimi se është e dokumentuar në mënyrë të plotë pranë tatimeve.

1.74. Mospasja e dokumenteve nga organet shtetërore në regjistrat e tyre elektronikë (ku nuk sqarohet se kur janë krijuar këto regjistra dhe çfarë *database* përmbajnë) nuk bën të pavërtetë një fakt për të cilin prindërit, familjarët e subjektit dhe vetë ai janë dëshmitarë. Më tej, subjekti shpjegon se në kuadër të veprimtarisë tregtare është fokusuar energjia e gjithë familjarëve dhe e babait të tij në funksion të kësaj veprimtarie, ku në vitin 1994 bleu edhe një furgon tip “Fiat Ducato”, të regjistruar me targa në Shkodër. Ky furgon është shitur më pas në vitin 1997, pasi babai i subjektit u rikthye në detyrë si oficer policie.

1.75. Më tej, subjekti deklaroi se për shkak të kohës së gjatë dhe mospasjes së detyrimit ligjor nga prindërit e tij për ruajtjen e dokumentacionit për sa më sipër, nuk mund të paraqesë ndonjë dokument të drejtpërdrejtë. Por, prindërit arritën të kontaktojnë blerësin e furgonit, i cili ka lëshuar një deklaratë me shkrim, ku përcakton se e ka blerë furgonin në vitin 1997, në vlerën 200.000 lekë, por se për shkak të kohës së gjatë të kaluar aktualisht nuk e disponon më as automjetin dhe as dokumentacionin.

1.76. Subjekti ka bashkëlidhur në deklaratën me shkrim një fotografi të atyre viteve, ku duket babai, vëllai dhe dy nipërit e tij, si dhe automjeti në sfond. Ai përmend se në atë kohë arsyeja e blerjes së furgonit lidhej drejtpërdrejt me aktivitetin tregtar të shitjes me shumicë dhe pakicë të artikujve të ndryshëm industrialë dhe nuk kishte qëllim tjetër. Prindërit e subjektit janë dëshmitarë të sa më sipër dhe janë të gatshëm të dëshmojnë para Komisionit, nëse vlerësohet e arsyeshme.

1.77. *Për të ardhurat nga trashëgimia* – subjekti deklaroi se lidhur me këto të ardhura, përveç sqarimeve që ka dhënë në pyetësorët e mëparshëm (të cilave i qëndron plotësisht), duke pasur parasysh se sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, trashëgimia nuk tatohej, nuk mundet të ketë dokumente tatimore për këtë të ardhur.

1.78. Megjithatë, shprehet subjekti, ky fakt civil provohet me deklaratën shkresore dhe dëshminë e xhaxhait të tij, A.V., i cili ka qenë protagonist kryesor në këtë marrëdhënie, për sa i përket trashëgimitarëve të shtetasit M.V. Të njëjtën sasi markash gjermane që babai i subjektit ka përfituar nga trashëgimia, e ka përfituar edhe vëllai i tij i vogël, H.V., të cilit ia ka dorëzuar xhaxhai tjetër, A.V. (fakt që konfirmohet me deklaratën shkresore të H.V., e cila do të bashkëlidhet). Subjekti, më tej, kërkon që z. H.V. mund të dëgjohet si dëshmitar për këtë fakt.

1.79. Më tej, edhe deklarata me shkrim e shtetasit B.V. (djali i djalit të xhaxhait të babait të subjektit) hedh dritë për sa më sipër, pasi edhe ai ka qenë protagonist bashkë me xhaxhain A.V.

⁴⁰ (i) deklarata noteriale e babait të subjektit; (ii) ekstrakti nga QKR; dhe (iii) licenca profesionale.

në marrjen e trashëgimisë në Kosovë. Edhe shtetasi B.V. është i gatshëm të dëshmojë si dëshmitar për sa më sipër.

1.80. Subjekti ka vënë në dispozicion edhe disa prova indirekte që i përkasin viteve 2000 – 2002⁴¹ dhe pretendon se këto dokumente provojnë pasjen e markave gjermane që vëllai i babait të tij ia kishte dhënë gjatë viteve 1999 – 2001 dhe përdorimin civil të tyre. Po ashtu, likuiditetet e babait në vitet 2000 provohen edhe nga kontrata e huas nr. ***, datë 13.4.2000, për vlerën 750.000 lekë dhe kontrata e huas nr. ***, datë 12.3.2002, në vlerën 700.000 lekë.

1.81. Përveç kontratave të mësipërme, si prova shtesë shkresore subjekti paraqiti edhe shkresat private të xhaxhit të tij, H.V., dhe të kushëririt, B.V., të cilët konfirmojnë faktet e sipërcituara.

1.82. Në lidhje me çmimin e kontratës së shitjes datë 1.12.2009 (tokë pemëtore + truall + ndërtesë) – subjekti deklaron se nga shpjegimet që i ka dhënë babai dhe nga vetë përmbajtja e kësaj kontrate rezulton se ajo është një marrëdhënie juridike-civile e lidhur me vullnetin e lirë të palëve dhe çmimi i përcaktuar në të është rrjedhojë e lirisë kontraktore të këtyre palëve. Kjo pronësi është fituar nga babai i subjektit në vitin 2003, kur ai ishte ende student dhe është shitur gjashtë vjet më pas, pa pasur subjekti ndonjë dijeni dhe duke mos pasur asnjë lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me punën e tij si gjyqtar.

1.83. Në lidhje me analizën financiare për pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e personave të tjerë të lidhur, A. dhe H.V. – subjekti i rivlerësimit deklaron se metodologjia e Komisionit nuk ka mbajtur parasysh jetesën e përbashkët familjare si një njësi e vetme ekonomike.

1.84. Subjekti shprehet se llogaritjet e relacionit kanë karakter mekanik dhe nuk mbajnë parasysh faktorët realë të jetesës familjare, si dhe barrën e provës që ligjërisht mund të mbajë subjekti.

1.85. Subjekti deklaron se përbërja e plotë familjare deri në vitin 2011 (pra, deri pak përpara kohës kur prindërit i dhuruan apartamentin), është si vijon: (i) 1994 - 1996 – 5 anëtarë, familja përbëhej nga 5 persona: A.V. (kryefamiljar), H.V. (bashkëshortja), A.V. (i biri), A.V. (e bija) dhe Asim Vokshi (i biri); (ii) në vitin 1997 – 5 anëtarët e mësipërm; (iii) nga gjysma e dytë e vitit 1998 deri në vitin 2001 – 4 anëtarë, janë katër persona, pasi vëllai i tij A.V. filloi studimet e larta në Akademinë e Policisë Tiranë, të cilat i vijoi deri në vitin 1999 dhe më pas nga viti 1999 deri në vitin 2004 nuk ka qenë pjesë e ekonomisë familjare, pasi është shkolluar në Akademinë e Policisë në Ankara, Turqi. Kostot e shkollimit dhe jetesës së tij gjatë këtyre viteve u mbuluan nga institucionet arsimore ku ai u shkollua⁴²; (iv) deri në mars të vitit 2002 – 4 anëtarë, motra e tij, A.V., ka qëndruar në një ekonomi familjare me anëtarët e tjerë, duke qenë familja e përbërë nga 4 anëtarë. Siç rezulton nga certifikata familjare nr. ***, datë 6.10.2011, motra e subjektit është shkëputur nga trangu familjar në datën 8.3.2002, për shkak martesë. E motra, me përfundimin e studimeve në Fakultetin e Ekonomisë në UT, u punësua si pedagoge

⁴¹ Katër kontrata huaje, me anë të të cilave babai i subjektit ka dhënë hua 30.000 DM dhe 1.450.000 lekë tek persona të tretë: (i) kontratën e huas nr. *** rep., datë 31.5.2000, babai i subjektit ka dhënë hua 20.000 DM; (ii) me kontratën e huas nr. ***, datë 24.2.2001, babai i subjektit ka dhënë hua edhe 10.000 DM; (iii) kontrata e huas nr. ***, datë 13.4.2000, për vlerën 750.000 lekë; dhe (iv) kontrata e huas nr. ***, datë 12.3.2002, në vlerën 700.000 lekë.

⁴² Bashkëlidhur subjekti ka dërguar vërtetimin nr. *** prot., datë 6.2.2020 dhe vendimin nr. *** prot., datë 13.2.2020.

e brendshme në këtë fakultet, duke filluar nga shtatori i vitit 2001 dhe kësisoj duke dhënë kontributin e saj në ekonominë e përbashkët familjare, deri në momentin e largimit⁴³; (v) mars 2002 - gjysma e dytë e 2004 – 3 anëtarë, subjekti, babai dhe nëna; (vi) gjysma e dytë e vitit 2004 deri në gjysmën e dytë të vitit 2008 – 4 anëtarë, babai, nëna, vëllai dhe subjekti; (vii) nga shtatori i vitit 2008 deri në fillim të vitit 2011 – 3 anëtarë, babai, nëna dhe subjekti.

1.86. Më tej, subjekti shprehet se shpjegimi i mësipërm për përbërjen fizike të anëtarëve të familjes në periudha të ndryshme, për efekt të llogaritjes së shpenzimeve të jetesës për anëtarët përkatës, si dhe totalit të të ardhurave që të gjithë anëtarët kanë kontribuar herë pas here në ekonominë e përbashkët familjare, e cila administrohej nga prindërit në mënyrë të centralizuar. Pra, sipas subjekti, secili anëtar, kur ka nxjerrë të ardhura, i ka depozituar tërësisht në buxhetin familjar të administruar nga prindërit, të cilët kanë mbuluar shpenzimet e jetesës dhe kursenin diferencën për të ardhmen.

1.87. Më tej, subjekti shpjegon se në rastin e tij, për shkak edhe të specifikave të profesionit që do të ushtronte, të gjitha të ardhurat deri në fillimin e vitit 2006 janë mbledhur dhe kursyer të plota nga prindërit. Për këtë arsye, në konsultim edhe me prindërit e tij, kur ka plotësuar deklaratën e pasurisë së vitit 2006, ka reflektuar të gjithë gjendjen e pasurisë që prindërit kishin kursyer për subjektin. Kjo edhe për shkak se, sipas nenit 22, të ligjit nr. 8136, datë 31.7.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, në eventualitetin e refuzimit të emërimit, do të kishte detyrimin të kthente shumat e marra nga Shkolla e Magjistraturës.

1.88. Pas vitit 2006, në funksion të ekonomisë së përbashkët familjare, administrimi i të ardhurave ka vijuar njësoj nga prindërit, por pjesa që kursehej posaçërisht për subjektin ndahej veç, për efekt të deklarimit periodik të pasurisë prej subjektit. Pjesa që mbetej është administruar nga prindërit e tij dhe është bërë pjesë e buxhetit familjar, ku mbulohehin kostot e jetesës për të dhe kursehej diferenca rast pas rasti.

1.89. Duke pasur parasysh sa më lart shpjegon subjekti, në analizën financiare për të ardhurat dhe shpenzimet e prindërve të tij, duhet mbajtur parasysh edhe kontributi i të gjithë anëtarëve të familjes për periudhat përkatëse kur ata kanë nxjerrë të ardhura, të cilat janë derdhur në buxhetin e përbashkët familjar.

1.90. Kjo pasi familja ka vepruar si një njësi e vetme ekonomike dhe jo secili anëtar të menaxhonte në mënyrë të pavarur të ardhurat e tij.

1.91. Subjekti thekson se në deklaratën “Vetting” dhe deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, kur ka deklaruar burimin e të ardhurave për blerjen nga prindërit të apartamentit dhe më pas dhurimin e tij subjektit, i është referuar kursimeve të jetës së tyre, ku natyrisht në optikën e mësipërme përfshihen të gjitha burimet e të ardhurave që kanë administruar nga të gjithë anëtarët e njësisë familjare.

1.92. Më tej, në lidhje me shpenzimet *TIMS* për vitin 2005 në vlerën 24.516 lekë, subjekti deklaron se nuk qëndrojnë, pasi në datën 8.11.2005 ka udhëtuar bashkë me kolegë të tjerë, gjë e cila mund të verifikohet lehtësisht nga sistemi *TIMS* (në lidhje me udhëtarët e automjetit furgon me targa ***, në atë datë). Arsyeja e udhëtimit dhe qëndrimit në Maqedoni në datat 8-

⁴³ Bashkëlidhur subjekti ka dërguar vërtetimin e pagës së të motrës, A.V., dhe certifikatën familjare me shënimin përkatës.

11 nëntor të vitit 2005 ka qenë pjesëmarrja në një seminar të organizuar me fondet e Bashkimit Europian për çështje të konkurrencës. Kostot e udhëtimit dhe të qëndrimit janë mbuluar nga organizatorët e këtij eventi, por për shkak të kohës së largët subjekti nuk ka mundësi të gjejë informacion të mëtejshëm.

1.93. Gjithashtu, në llogaritjet e bëra nga subjekti në kohën e plotësimit të deklaramin të parë të pasurisë në vitin 2006, janë përfshirë edhe kursimet nga pagesat nga Këshilli i Europës në kuadër të vizitës studimore në Këshillin e Europës, Strasbourg, Francë. Në atë kohë Këshilli i Europës i bënte pagesat e vizitorëve me para në dorë (nëpërmjet çekut që thyhej në bankën e ndodhur në godinën e Këshillit të Europës) dhe më pas vlera e tyre përdorej nga i ftuari për pagesën e hotelit dhe ushqimit. Duke qenë se në atë kohë ka qëndruar në një hotel me çmime modeste, larg nga godina e Këshillit të Europës, si dhe shpenzimet e ushqimit kanë qenë minimale për shkak të përdorimit të mencës së Këshillit të Europës, kostot e tij kanë qenë aq të ulta, sa kanë lejuar kursimin në vlerën rreth 100.000 lekë.

1.94. Subjekti shpjegon se sipas shkresës nr. *** prot., datë 18.10.2019, të Shkollës së Magjistraturës (bashkëlidhur së cilës janë shkresat justifikuese), duke qenë se dokumenti i datës 11.5.2005 nuk ka referencë për pagesat që do të merrnin vizitorët, i referohet për analogji shkresës tjetër datë 31.3.2008, e cila përcakton se pagesa për vizitorët në Këshillin e Europës është 172 euro/ditë. Shpenzimet e tij ditore kanë qenë rreth 50 euro, nga ku del edhe vlera e përafërt e asaj që ka kursyer.

1.95. Në lidhje me shpenzimet e *TIMS*-it: (a) në vitin 2006 subjekti vizituar vetëm për një natë të afërmit në Kosovë dhe vlera prej 24.770 lekësh, e llogaritur si shpenzim, është tepër e lartë për këtë lloj udhëtimi; (b) në vitin 2007 subjekti ka realizuar dy udhëtime jashtë shtetit, me organizimin e Shkollës së Magjistraturës, konfirmuar edhe nga shkresa nr. *** prot., datë 18.10.2019, e Shkollës së Magjistraturës. Konkretisht, udhëtimi në Sirakuza, Itali, në datat 24.10.2007 – 2.11.2007, si dhe udhëtimi në Athinë në datat 7.5.2007 – 11.5.2007, kanë qenë udhëtime në programe studimore-profesionale, kostot e të cilave janë mbuluar nga organizatorët e atyre vendeve. Për rrjedhojë, në atë vit, subjekti nuk ka pasur shpenzime *TIMS*-i; (c) në vitin 2008, për sa i përket vizitës studimore në Strasbourg, subjekti sqaron se referuar shkresës nr. *** prot., datë 18.10.2019, të Shkollës së Magjistraturës nuk ka pasur asnjë kosto udhëtimi apo qëndrimi në atë rast. Ndërsa, udhëtimi tjetër në datat 16 - 20.9.2008 është financuar nga projekti GTZ i Ambasadës Gjermane, për pjesëmarrjen në seminarin trajnues me temë “Tregjet Financiare”. Si provë për sa më sipër, subjekti ka vënë në dispozicion ftesën e datës 6.8.2008 të GTZ-së, ku theksohet se shpenzimet janë të mbuluara.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

1.96. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaramin e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, Vetting”; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratave periodike dhe provave shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaramin në seancë dëgjimore, arsyeton se:

1.97. Së pari, duhet analizuar provueshmëria ose jo e burimit të ligjshëm të të ardhurave të personave të tjerë të lidhur/dhuresve, A. dhe H.V., për blerjen e pasurisë apartament 1+1, me sip. 43 m², e ndodhur në ***, Tiranë, me çmim 21.350 euro, në vitin 2011, në kuptim të pikave 1 dhe 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

1.98. Së dyti, provueshmëria e deklaramit dhe e pagimit të detyrimeve tatimore për të ardhurat të cilat kanë shërbyer si burim krijimi i kësaj pasurie, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, nga ana e personave të tjerë të lidhur.

1.99. Nga analiza e akteve administrative, të shqyrtuara gjatë hetimit, prapësimet e subjektit në përgjigje të barrës së provës dhe seancës dëgjimore, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ky apartament i është dhuruar nga prindërit⁴⁴, të cilët e kanë blerë me kursimet e jetës, sipas dokumenteve ligjore justifikuese⁴⁵.

1.100. Në lidhje me analizën financiare të familjes në tërësi – Komisioni vlerëson se analiza financiare duhet kryer duke e ndarë në dy periudha: periudha 1994 – 2010; dhe periudha 2011 – 2016 (trajtuar më tej në paragrafin 6.9).

1.101. Për periudhën 1994 – 2010, Komisioni u bazua në përbërjen familjare ndër vite të deklaruar nga subjekti në shpjegimet e tij.

1.102. Në lidhje me të ardhurat shtesë të përfituara nga babai i subjektit, të evidentuara në llogarinë bankare në “Raiffeisen Bank”⁴⁶, Komisioni identifikoi këto transferta dhe konstatoi që të ardhurat e përfituara me transfertë bankare për vitet 2006 dhe 2008⁴⁷ janë më të larta se ato që paraqiten në vërtetimet përkatëse⁴⁸, për këtë arsye vlerëson se duhet të merren në konsideratë sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit.

1.103. Në përputhje me kryerjen e analizës financiare, bazuar në përbërjen familjare ndër vite të deklaruar nga subjekti, u morën në konsideratë të ardhurat e vëllait dhe motrës së subjektit, sipas dokumentacionit ligjor justifikues⁴⁹ të dorëzuar.

1.104. Lidhur me të ardhurat e subjektit që kanë kontribuar në buxhetin familjar ndër vite, Komisioni e mori në konsideratë kërkesën e subjektit, duke i zbritur shumës së të ardhurave të tij prej 5.933.540 lekësh të përfituara gjatë periudhës 2002 – 2010, këto pasuri dhe shpenzime: kursime *cash* përpara fillimit të detyrës në shumën 1.580.000 lekë; shtesë kursime *cash* për

⁴⁴ Sipas kontratës së dhurimit nr. ***, datë 23.12.2011.

⁴⁵ (i) Kontratë shitje nr. ***, datë 20.1.2011; (ii) vërtetim nr. ***, datë 1.12.2016; (iii) vërtetim nr. ***, datë 1.12.2016; (iv) deklaratë nr. ***, datë 1.12.2016; (v) kontratë nr. ***, datë 30.5.2000, (vi) kontratë nr. ***, datë 26.7.1994; (vii) vërtetim pagash të babait të subjektit për vitet 1994 – 2009; (viii) katër kontrata huaje, me anë të të cilave babai i subjektit ka dhënë hua 30.000 DM dhe 1.450.000 lekë tek persona të tretë, ku me kontratën e huas nr. *** rep., datë 31.5.2000, babai i subjektit ka dhënë hua 20.000 DM dhe me kontratën e huas nr. ***, datë 24.2.2001, babai i subjektit ka dhënë hua edhe 10.000 DM; (ix) vërtetimin nr. *** prot., datë 6.2.2020, dhe vendimin nr. *** prot., datë 13.2.2020; (x) vërtetimin e pagës së motrës, A.V., dhe certifikatën familjare me shënimin përkatës.

⁴⁶ Datë 20.7.2005, shuma 88.400; datë 20.12.2006, shuma 207.684 lekë; datë 26.11.2008, shuma 267.954 lekë.

⁴⁷ Për vitin 2005 transfertat bankare fillojnë më 6.6.2005 dhe, si rrjedhim, nuk është i mundur krahasimi.

⁴⁸ Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare nga Komisariati i Policisë Krujë, Drejtoria e Policisë Qarku Durrës, Drejtoria Vendore e Policisë Dibër.

⁴⁹ Për znj. A.V. vërtetim datë 13.2.2020, nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë; për z. A.V. vërtetim nr. *** prot., datë 18.10.2019, Drejtoria Vendore e Policisë Korçë; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Emigracionin; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare nr. *** datë 21.10.2019, Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë.

periudhën 2006 – 2010 në shumën 2.896.902 lekë; shpenzime *TIMS* për periudhën 2005 – 2010 në shumën 96.663 lekë (të saktësuara pas prapësimeve)⁵⁰; gjendje llogarie bankare në shumën 6.024 lekë.

1.105. Në lidhje me shpenzimet jetike, Komisioni vlerëson se këto shpenzime duhet të rillogariten, bazuar në numrin e anëtarëve të familjes sipas deklarimeve të subjektit në prapësimet e barrës së provës dhe dokumentacionit provues si certifikata familjare, si më poshtë vijon:

Periudha	Anëtarë	Shpenzime jetike
1994 – 1996	5	125,701
1997	5	300,000
janar – qershor 1998	5	150,000
korrik – dhjetor 1998	4	120,000
1999	4	240,000
2000	4	432,000
2001	4	432,000
janar – shkurt 2002	4	62,576
mars – dhjetor 2002	3	234,660
2003	3	281,592
janar – qershor 2004	3	140,796
korrik – dhjetor 2004	4	187,728
2005	4	438,228
2006	4	438,228
2007	4	696,288
janar – gusht 2008	4	364,320
shtator – dhjetor 2008	3	136,620
2009	3	409,860
2010	3	409,860
TOTALI		5,600,457

1.106. Në seancën dëgjimore subjekti i rivlerësimit paraqiti dokumentacion lidhur me të ardhurat e babait të tij nga taksa e solidaritetit dhe shpërblime gjatë periudhës 1997 – 2002.

⁵⁰ (1) Për vitin 2005 është kryer përlllogaritja e shpenzimeve të transportit, ndërsa për qëndrimin dhe akomodimin subjekti nuk dorëzoi dokumentacion justifikues; (2) për vitin 2006 u krye saktësimi i shpenzimeve bazuar në destinacionin e deklaruar; (3) për vitin 2007 nuk pati ndryshime, pasi nga Komisioni ishin përlllogaritur vetëm shpenzime qëndrimi dhe akomodimi për dy ditë, në kushtet që kthimi i subjektit sipas sistemi *TIMS* ishte në datën 4.11.2007, ndërsa institucioni merrte përsipër shpenzimet deri në datën 2.11.2007; (4) për vitin 2008 u krye reduktimi i shpenzimeve sipas dokumentacionit të dorëzuar, sipas të cilit GIZ mbulonte transportin dhe akomodimin (me përjashtim të dietave).

Subjekti shpjegon se babai i tij ka përfitur rreth 350.000 lekë të ardhura nga taksa e solidaritetit, bazuar në: (i) ligjin nr. 8435, datë 28.12.1999, neni 6, germa “r”, lidhja 10, pika 6; (ii) VKM-në nr. 704, datë 7.11.1998, “Për trajtimin me shpërblim të ushtarakëve të sistemit të Rendit Publik, Brigadës Komando dhe Policisë Ushtarake”, të ndryshuar; (iii) Urdhrit nr. 7/448, datë 26.11.1998, të Ministrit të Rendit Publik, “Për trajtimin me shpërblim të ushtarakëve funksioneve organike, ushtarake, në sistemin e Ministrisë së Rendit Publik”, i ndryshuar me Urdhrit nr. 35, datë 15.3.1999, si dhe urdhrat e Ministrit të Rendit Publik; dhe (iv) autorizimet nr. 4493, datë 14.9.1999, nr. 6684, datë 29.12.1999, të Ministrisë së Financave për përdorimin e të ardhurave nga taksa e solidaritetit. Gjithashtu, subjekti shpjegon se babai i tij ka përfitur shumën 70.000 lekë nga shpërblimet gjatë vitit 1997, në zbatim të Vendimit nr. 137, datë 15.3.1997, të Këshillit të Ministrave, “Për shpërblimin e punonjësve të Ministrisë së Brendshme”.

1.107. Si rrjedhojë e sa më lart, në analizën financiare deri në vitin 2010 (para se të blihej apartamenti nga babai i subjektit) u morën në konsideratë: (1) pensione dhe paga nga prindërit e subjektit në shumën 6.139.694 lekë; (2) pagesa nga punësimi në shoqërinë “****” sh.p.k., në shumën 300.000 lekë; (3) dëmshpërblime dhe shpërblime shtesë nga marrëdhënia e punës në vitet 2005 - 2008 për babain e subjektit (sipas ekstraktit bankar të periudhës 31.12.2004 – 21.9.2010, printuar nga “Raiffeisen Bank”) në shumën 564.038 lekë; (4) të ardhurat nga shitja e apartamentit në qytetin e Lezhës dhe të shtëpisë në qytetin e Shkodrës në shumën 1.500.000 lekë; (5) të ardhurat nga diferenca e çmimit të shitjes me atë të blerjes në pasuritë e paluajtshme (pemëtore, truall dhe ndërtesë në qytetin e Krujës, si dhe truall dhe ndërtesë trekatëshe në qytetin e Tiranës) në shumën 1.388.776 lekë; (6) të ardhurat nga punësimi i motrës së subjektit në periudhën shtator 2001 – shkurt 2002, në shumën 142.385 lekë; (7) të ardhura nga paga e vëllait të subjektit, në gjysmën e dytë të vitit 2004 deri në gusht të vitit 2008, në shumën 2.074.006 lekë; (8) të ardhura nga paga e subjektit në vitet 2006 – 2010, e derdhur në buxhetin familjar, duke përjashtuar kursimet e deklaruara në ILDKPKI në emër të subjektit në shumën 1.353.951⁵¹; (9) të ardhura nga taksa e solidaritetit dhe shpërblime në shumën 420.000 lekë. Shuma totale e të ardhurave të personave të tjerë të lidhur dhe subjektit deri në fillim të janarit të vitit 2011 është 13.882.850 lekë.

1.108. Në shpenzimet familjare të personave të tjerë të lidhur dhe subjektit të rivlerësimit deri në fillim të vitit 2011, janë përfshirë: (1) shpenzimet jetike të familjarëve, sipas periudhave të bashkëjetesës, siç është trajtuar më lart, në shumën 5.600.457 lekë; (2) blerje apartamenti me sip. 80 m², në Tiranë, në shumën 3.155.263 lekë; (3) blerje apartamenti me sip. 57.41 m², në Kashar, në shumën 2.947.076 lekë⁵²; (4) blerje apartamenti me sip. 43 m², në Farkë, në shumën 3.000.000 lekë (apartamenti i dhuruar subjektit); dhe (5) shpenzime për blerjen e automjetit me targa *** në shumën 354.555 lekë. Shuma totale e shpenzimeve të personave të tjerë të lidhur dhe subjektit deri në fillim të janarit të vitit 2011 është 15.057.351 lekë.

⁵¹ Të detajuara në paragrafin 1.104

⁵² Vërtetim datë 14.2.2020, nga shoqëria “****” sh.p.k., ku konfirmohet se pagesa e shumës 2.200 euro është kryer në datën 30.9.2019, në momentin e hartimit të kontratës përfundimtare pranë noteres dhe regjistrimit në emër të blerësit pranë ZVRPP-së Tiranë.

1.109. Pra, diferenca midis të ardhurave në shumën 13.882.850 lekë dhe totalit të shpenzimeve në shumën 15.057.351 lekë, për personat e tjerë të lidhur, A. dhe H.V., është në shumën 1.174.502 lekë.

1.110. Si përfundim të sa më lart, nga analiza financiare rezulton se personat e tjerë të lidhur kanë pasur mungesë të të ardhurave financiare, shoqëruar me dokumentacion justifikues, në shumën 1.174.502 lekë, për blerjen e apartamentit.

1.111. Në lidhje me të ardhurat nga: (1) trashëgimia nga gjyshi në Kosovë në vitet 1999 - 2001 në shumën 2.469.200 lekë; dhe (2) ushtrimi i aktivitetit privat në qytetet Lezhë dhe Shkodër në vitet 1994 - 1997 në shumën 5.000.000 lekë – Komisioni vlerëson se nuk duhen marrë në konsideratë si të ardhura të ligjshme, pasi provat dhe faktet e paraqitura nga subjekti nuk provojnë direkt se këto janë të ardhura të ligjshme, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Gjithashtu nuk u morën në konsideratë të ardhurat nga shoqëria “***” sh.p.k., për shkak se subjekti nuk dorëzoi prova të reja për të vërtetuar të ardhurat e babait nga punësimi në këtë shoqëri.

1.112. Gjithsesi, në lidhje me faktet dhe provat rrethore të administruara gjatë hetimit për këto dy të ardhura, Komisioni çmon se ato duhet gjithashtu t’i nënshtrohen vlerësimit, duke pasur parasysh: (i) periudhën e gjatë dhe të largët të burimit të përfitimit të këtyre të ardhurave nga personat e tjerë të lidhur, A. dhe H.V.; (ii) faktin që subjekti i rivlerësimit ka qenë minoren dhe më tej student gjatë kohës së fitimit të pjesës më të madhe të këtyre të ardhurave nga personat e tjerë të lidhur, A. dhe H.V.; si dhe (iii) faktin që subjekti ka depozituar disa prova rrethore, të cilat provojnë fluksin e parasë në familjen e tij, para se të ishte subjekt rivlerësimi/gjyqtar.

1.113. Faktet e sipërpërmendura në pikën 1.111 përbëjnë rrethana që duhet të merren parasysh në konstatimin se personat e tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit mund të kenë zotëruar këto të ardhura në periudhat të cilat pretendohen nga subjekti.

1.114. Për sa i përket të ardhurave nga trashëgimia, subjekti ka paraqitur disa akte shkresore që provojnë rrethana të rëndësishme në drejtim të provueshmërisë së këtyre të ardhurave, që i përkasin viteve 2000 - 2002⁵³. Po ashtu, likuiditetet e babait të subjektit në vitin 2000 provohen edhe nga kontrata e huas nr. ***, datë 13.4.2000, për vlerën 750.000 lekë dhe kontrata e huas nr. ***, datë 12.3.2002, për vlerën 700.000 lekë.

1.115. Në analizë të këtyre provave dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit mbi mënyrën e fitimit të të ardhurave nga trashëgimia dhe aktivitete të ndryshme private, trupi gjykues çmon se niveli i provueshmërisë për burimin e krijimit të këtyre të ardhurave, si të ardhura nga trashëgimia dhe aktivitete private, janë të tilla që të krijojnë bindjen për krijimin e tyre nga personat e tjerë të lidhur, duke pasur parasysh këtu situatën në Kosovë gjatë viteve 2000, faktin që personat e tjerë të lidhur/dhuresit nuk kanë qenë subjekte të deklarimit të pasurive, por dhe faktin që subjekti gjatë kësaj kohe ka qenë nxënës apo student.

⁵³ (i) Me kontratën e huas nr. *** rep., datë 31.5.2000, babai i subjektit ka dhënë hua 20.000 DM; (ii) me kontratën e huas nr. ***, datë 24.2.2001, babai i subjektit ka dhënë hua edhe 10.000 DM.

1.116. Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në këtë rast, duke u konsideruar si një nga mjetet për kërkimin e provës, në kuptim të germës “b”, të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, marrin vlerë provuese të rëndësishme, për sa kohë që gjejnë mbështetje dhe harmonizohen me të dhënat e informacionet rreth këtij fakti, që japin aktet e sipërcituara, të paraqitura prej subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, dhe që konsiderohen prova, në kuptim të germës “b”, të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016.

1.117. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se personat e tjerë të lidhur gjenden për arsye të ekzistencës së disa rrethanave që e vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon: [...] *Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme [...], për shkak se: (i) fakti që në kohën e krijimit të këtyre të ardhurave, personat e tjerë të lidhur, A. dhe H.V., prindërit e subjektit, nuk e gëzonin statusin e personave të tjerë të lidhur të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, dhe nuk kishin ndonjë detyrim ligjor të tregoheshin të kujdesshëm deri në nivelin e ruajtjes së dokumentacionit që provon ligjshmërinë e të ardhurave të tyre në atë kohë, përveç se, për sa ata kanë çmuar të nevojshme sipas kujdesit të çdo qytetari normal; (ii) koha e largët në të cilën janë krijuar këto të ardhura e bën të vështirë edhe vetë ruajtjen e dokumentacionit që mund të sillte edhe më tepër informacion në këtë drejtim, edhe për shkak të një logjike normale ligjore që duket se nuk merr përsipër të ruajë apo arkivojë dokumente të kësaj natyre për një periudhë kaq të gjatë kohe, madje as nga vetë institucionet shtetërore.*

1.118. Në përfundim të sa më lart, Komisioni vlerëson se mungesa e të ardhurave financiare, shoqëruar me dokumentacion ligjor justifikues, nga personat e tjerë të lidhur, A. dhe H.V., në shumën 1.174.502 lekë, për blerjen jo vetëm të apartamentit të dhuruar subjektit, por edhe të pasurive të tjera, si dhe për kryerjen e shpenzimeve, të shtrira të gjitha këto në një periudhë 16-vjeçare (1994 – 2010), faktet dhe provat rrethanore, të krijojnë bindjen se personat e tjerë të lidhur mund t'i kenë pasur këto të ardhura në kohën e blerjes së apartamentit. Për rrjedhojë, mungesa e dokumentacionit ligjor justifikues për shumën 1.174.502 lekë, nga personat e tjerë të lidhur, nuk përbën shkak për deklaram të pamjaftueshëm nga subjekti i rivlerësimit për kriterin e pasurisë, sipas pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

1.119. Si konkluzion, Komisioni vlerëson se në analizë të rasteve të parashikuara nga neni 61 i ligjit nr. 84/2016, të analizuara më lart, nuk ekziston asnjë prej situatave ligjore që do ta çonte subjektin drejt aplikimit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sepse subjekti i rivlerësimit: (i) nuk ka mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (ii) nuk ka bërë deklaram të rremë; (iii) nuk ka bërë fshehje të pasurisë; (iv) nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit.

2. Depozitë bankare në USD në “Bankën Kombëtare Tregtare” sh.a.

Faktet nga hetimi administrativ kryesisht, shpjegimet dhe provat e subjektit në përgjigje të barrës së provës, si dhe seanca dëgjimore

2.1 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një depozitë bankare në USD, në “Bankën Kombëtare Tregtare” sh.a., të hapur në datën 5.9.2016, në vlerën 20.256 USD. Pjesa takuese: 100 %.

2.2 Si burim krijimi subjekti deklaron se ka shërbyer depozita e mëparshme në të njëjtën bankë, si dhe kursime nga paga ndër vite.

2.3 Subjekti, për vërtetimin e deklarimeve ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁵⁴.

2.4 Nga dokumentacioni i administruar nga “Banka Kombëtare Tregtare”⁵⁵ konfirmohet se subjekti i rivlerësimit në datën 23.1.2017 ka një depozitë në vlerën 20.256,12 USD. Gjithashtu, konstatohet se kjo depozitë është krijuar nga: (1) depozitimi *cash* nga subjekti në datën 8.8.2014, në shumën 15.000 USD; (2) depozitimi *cash* nga subjekti në datën 5.9.2016, në shumën 5.000 USD; (3) interesa bankare në shumën 256,12 USD.

2.5 Në lidhje me mjaftueshmërinë e burimit të krijimit – në deklaratën e interesave private të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit deklaron shtim gjendjeje të parave në depozitën me afat 1-vjeçar, në “Bankën Kombëtare Tregtare”, në shumën 15.000 USD dhe pakësim të gjendjes së parave *cash* të deklaruara më parë, të cilat janë këmbyer gjatë vitit 2014 në USD dhe depozituar në këtë valutë.

2.6 Në deklaratën e interesave private të vitit 2016, subjekti i rivlerësimit deklaron shtesë të depozitës me afat 1-vjeçar në USD, në shumën 5.000 USD, me burim vlerën e parave *cash* në lekë të pakësuara.

2.7 Nga analizimi i deklarimeve të gjendjes *cash* nga viti 2005 deri në vitin 2016, të paraqitura në tabelën “analizë e ecurisë së gjendjes së kursimeve në *cash*, bazuar në deklaratimet periodike” (aneksi 2 në rezultatet e hetimit), Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të mjaftueshme për krijimin e kësaj depozite bankare.

2.8 Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë depozitë në “Bankën Kombëtare Tregtare”, si dhe ka burime të ligjshme shoqëruar me dokumentacion justifikues ligjor për krijimin e saj.

3. Depozitë bankare në euro në “Credins Bank” sh.a.

Faktet nga hetimi administrativ kryesisht, shpjegimet dhe provat e subjektit në përgjigje të barrës së provës, si dhe seanca dëgjimore

3.1 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka një depozitë bankare në euro në “Credins Bank” sh.a., hapur në datën 5.9.2016, në vlerën 16.000 euro. Pjesa takuese: 100 %.

3.2 Si burim krijimi subjekti deklaron se kanë shërbyer paga dhe shpërblime të tjera të kursyera ndër vite.

⁵⁴ Kontratë depozite në BKT, lidhur në datën 5.9.2016, për vlerën 20.256 USD, në emër të z. AsimVokshi + mandat derdhje BKT, *statement* datë 9.8.2016; vërtetimi nr. ***, datë 26.10.2016; vërtetimi nr. ***, datë 12.1.2017, vërtetim page si gjyqtar për vitet 2005 – 2016.

⁵⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 15.1.2019.

3.3 Subjekti, për vërtetimin e deklarimeve, ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁵⁶.

3.4 Nga dokumentacioni i administruar nga “Credins⁵⁷ Bank” konfirmohet se subjekti i rivlerësimit, në datën 23.1.2017 ka një depozitë në vlerën 16.000 euro. Gjithashtu, konstatohet se kjo depozitë është krijuar nga një depozitim *cash* nga subjekti i rivlerësimit në datën 5.9.2016, me përshkrim “të ardhura nga kursime page ndër vite”, në shumën 16.000 euro.

3.5 Në lidhje me mjaftueshmërinë e burimit të krijimit – në deklaratën e interesave private të vitit 2016 subjekti i rivlerësimit deklaroi depozitë bankare në euro, hapur në datën 5.9.2016, në shumën 16.000 euro, me burim vlerën e parave *cash* në lekë të pakësuar.

3.6 Nga analizimi i deklarimeve të gjendjes *cash* nga viti 2005 deri në vitin 2016, të paraqitura në tabelën “analizë e ecurisë së gjendjes së kursimeve në *cash* bazuar në deklaratimet periodike” (detajuar në rezultatet e hetimit), Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të mjaftueshme për krijimin e kësaj depozite bankare.

3.7 Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë depozitë në “Credins Bank”, si dhe ka burime të ligjshme shoqëruar me dokumentacion justifikues ligjor për krijimin e saj.

4. Llogari rrjedhëse në “Credins Bank” sh.a.

Faktet nga hetimi administrativ kryesisht, shpjegimet dhe provat e subjektit në përgjigje të barrës së provës, si dhe seanca dëgjimore

4.1 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka një llogari rrjedhëse në “Credins Bank” sh.a., me gjendje 500.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

4.2 Si burim krijimi subjekti deklaroi se kanë shërbyer paga dhe shpërblime të tjera të kursyera ndër vite.

4.3 Subjekti, për vërtetimin e deklarimeve, ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁵⁸.

4.4 Nga dokumentacioni i administruar nga “Credins⁵⁹ Bank” konfirmohet se subjekti i rivlerësimit në datën 23.1.2017, zotëron llogari në vlerën 500.000,69 lekë. Gjithashtu, konstatohet se kjo gjendje është krijuar depozitim *cash* nga subjekti i rivlerësimit në datën 9.1.2017, i shumës 500.000 lekë.

4.5 Në lidhje me mjaftueshmërinë e burimit të krijimit – nga analizimi i deklarimeve të gjendjes *cash* nga viti 2005 deri në vitin 2016, të paraqitura në tabelën “analizë e ecurisë së gjendjes së kursimeve në *cash* bazuar në deklaratimet periodike” (detajuar në rezultatet e hetimit), Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të mjaftueshme për krijimin e kësaj depozite bankare.

⁵⁶ Kontratë depozite nr. ***, datë 5.9.2016, në emër të z. Asim Vokshi, në vlerën 16.000 euro; vërtetim nr. ***, datë 26.10.2016; vërtetim nr. ***, datë 12.1.2017, vërtetim page si gjyqtar për vitet 2005 – 2016.

⁵⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 11.2.2019.

⁵⁸ Nxjerrje llogarie në emër të z. Asim Vokshi, datë 9.1.2017, në vlerën 500.000 lekë + mandatarkëtimi, *statement* datë 9.1.2017, nga “Credins Bank”; vërtetim nr. ***, datë 26.10.2016; vërtetim nr. ***, datë 12.1.2017; vërtetim page si gjyqtar për vitet 2005 – 2016.

⁵⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 11.2.2019.

4.6 Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë llogari rrjedhëse në “Credins Bank”, si dhe ka burime të ligjshme shoqëruar me dokumentacion justifikues ligjor për krijimin e saj.

5. Kursime në gjendje *cash* të mbledhura gjatë viteve

Faktet nga hetimi administrativ kryesisht

5.1 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime në *cash* në vlerën 1.400.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

5.2 Si burim krijimi subjekti deklaroi se kanë shërbyer paga dhe shpërblime të tjera të kursyera ndër vite.

5.3 Subjekti, për vërtetimin e deklarimeve, ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁶⁰.

5.4 Në lidhje me mjaftueshmërinë e burimit të krijimit – nga analizimi i deklarimeve të gjendjes *cash* nga viti 2005 deri në vitin 2016, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të mjaftueshme për krijimin e kësaj gjendjeje *cash*.

5.5 Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka burime të ligjshme shoqëruar me dokumentacion justifikues ligjor për krijimin e gjendjes *cash*.

6. Analizimi i ligjshmërisë së burimit të krijimit për gjendjen e likuiditeteve në bankë dhe *cash*

Faktet nga hetimi administrativ kryesisht, shpjegimet dhe provat e subjektit në përgjigje të barrës së provës, si dhe seanca dëgjimore

6.1 Komisioni kreu analizën financiare për: pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit (nga fillimi deri në vitin 2013); dhe pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, bashkëshortes (2014 – 2016), si më poshtë vijon:

6.2 Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se subjekti dhe personi i lidhur kanë mungesë të ardhurash të ligjshme, shoqëruar me dokumentacion justifikues: (i) në shumën 593.926 lekë për krijimin e gjendjes fillestare *cash* dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën nga fillimi i punësimit deri në datën 31.12.2005; dhe (ii) në shumën 107.759 lekë për kryerjen e shpenzimeve dhe krijimin e pasurive për vitin 2012.

6.3 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, dha shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit dhe deklaroi se siç është theksuar edhe tek trajtimi i jetesës së përbashkët të njësisë ekonomike familjare, deri në fillim të vitit 2006, kohë gjatë së cilës subjekti ndiqte studimet, shpenzimet e jetesës së tij janë përballuar nga buxheti familjar. Kjo

⁶⁰ Nxjerrje llogarie page datë 26.9.2016, në emër të z. Asim Vokshi, për periudhën e kreditimit 2010 – 2016, nga “Credins Bank”; nxjerrje llogarie page datë 28.9.2016, në emër të z. Asim Vokshi, për periudhën e kreditimit 2005 – 2011, nga “Raiffeisen Bank”; vërtetim nr. ***, datë 26.10.2016; vërtetim nr. ***, datë 12.1.2017; vërtetim page si gjyqtar për vitet 2005 – 2016; kontratë datë 1.2.2014; kontratë datë 23.3.2015.

do të thotë se është e pasaktë zbritja e shpenzimeve jetike nga të ardhurat e tij në vitin 2006, sipas analizës së bërë nga Komisioni.

6.4 Për rrjedhojë, vlera prej 391.149 lekësh, në zërin shpenzime jetike sipas ILDKPKI-së për vitet 2002 – 2005, duhet t'i shtohet pjesës së kursyer nga subjekti, pasi të ardhurat e tij gjatë kësaj periudhe janë hequr të gjitha mënjane nga prindërit dhe për shkak të detyrimit ligjor për të kthyer vlerën e bursës së Shkollës së Magjistraturës në rast refuzimi të emërimit, sipas nenit 22 të ligjit të sipërcituar.

6.5 Në lidhje me balancën negative në vitin 2012, subjekti ka shpjeguar: *“...sa i përket konstatimit tjetër të KPK-së për mungesën e burimeve në shumën 107,759 lekë, në vitin 2012, dëshiroj të sqaroj se formularin e deklarimit për atë vit e kam plotësuar gjatë kohës që ndiqja në mënyrë intensive studimet master në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pas largimit tim nga Shqipëria në datën 5.7.2012, kartën e debitit të llogarisë së pagës ua kam lënë prindërve. Pas kësaj date kam përfituar dy pagesa pagash nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pagesën nga Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Tiranës. Në deklarimin periodik të vitit 2012, ka mbetur gabimisht e shënuar shprehja cash te kursimi 200,000 lekë, pasi kam menduar se prindërit e mi i kishin tërhequr ato para. Në fakt, siç rezulton nga ekstrakti bankar i llogarisë time rrjedhëse pranë ‘Credins Bank’ sh.a., prindërit e mi kanë bërë vetëm një tërheqje në shumën 30,000 lekë, në datën 30.10.2012, në një ATM në Peshkopi (ku im atë ishte i punësuar), në një kohë në të cilën unë isha fizikisht në SHBA. Ndaj, saktësoj se totali i kursimit atë vit ka qenë vetëm vlera e deklaruar prej 296,660 lekësh, e cila ka qenë një pjesë e vogël cash dhe shumica në llogari bankare. Pra, përveç shumës së sipërcituar nuk ka pasur kursim cash edhe të ndonjë vlere tjetër prej 200.000 lekësh, të deklaruar gabimisht në DPV-në e vitit 2012. Arsyeja e kësaj pasaktësie lidhet me ngarkesën e madhe në mësim në atë kohë, ngatërresën në komunikimin me prindërit dhe pamundësinë e kontrollit online të llogarisë rrjedhëse”.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

6.6 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratat e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, Vetting”; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratat në seancë dëgjimore, arsyeton se:

6.7 Në lidhje me analizën financiare të familjes në tërësi – Komisioni vlerëson se analiza financiare duhet kryer duke e ndarë në dy periudha: periudha 1994 – 2010, e trajtuar në paragrafin 1.1011; dhe periudha 2011 – 2016, e trajtuar në vazhdimësi.

6.8 Në lidhje me shpjegimin e subjektit për balancën negative prej 107.759 lekësh të vitit 2012, ku saktëson se shuma e deklaruar ka qenë gjendje *cash* dhe në llogari bankare, Komisioni, duke vlerësuar deklaratat vjetore periodike, vëren se subjekti ka deklaruar në vazhdimësi në të njëjtën mënyrë shumën *cash* të kursyer nga pagat dhe nga aktivitete të tjera. Për këtë arsye, pretendimi i subjektit për t'i zbritur gjendjet e likuiditeteve në llogaritë bankare nga kursimet *cash* nuk u mor në konsideratë.

6.9 Në përfundim, analiza financiare për periudhën 2011 – 2016 për pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet paraqitet, si më poshtë vijon:

Viti	Pasuri	Shtesë / pakësim likuiditete		Të ardhurat	Shpenzime	Balanca e fondeve
		Cash	Bankë			
2011	-	570,000	- 4,903	999,744	277,774	156,873
2012	-	296,660	214,489	643,403	240,013	-107,759
2013	-	-	- 214,275	526,300	489,239	251,337
2014	504,504	- 359,160	3,554,595	5,541,849	1,322,486	519,425
2015	-	708,647	90,494	2,726,645	1,011,271	916,233
2016	-	- 2,601,902	2,811,915	2,440,260	960,679	1,269,566
TOTAL	504,504	- 1,385,755	6,452,315	12,878,201	4,301,462	3,005,674

6.10 Në përfundim të sa më lart, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka një mungesë prej 107.759 lekësh për vitin 2012, shoqëruar me dokumentacion ligjor justifikues.

6.11 Në konkluzion, Komisioni vlerëson se mungesa e dokumentacionit ligjor justifikues për shumën prej 107.759 lekësh për vitin 2012, nuk përbën shkak për shkarkim, sipas pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

PASURITË E PERSONIT TË LIDHUR/BASHKËSHORTES SË SUBJEKTIT

7. Automjet tip “Daimler Chrysler C220”, viti i prodhimit 2002

Faktet nga hetimi administrativ kryesisht, shpjegimet dhe provat e subjektit në përgjigje të barrës së provës, si dhe seanca dëgjimore

7.1 Në deklaratën “Vetting” personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar se zotëron automjet tip “Daimler Chrysler C220”, i vitit 2002, blerë në datën 14.5.2014. Si burim krijimi ka deklaruar: shitja e automjetit të mëparshëm tip “Fiat Punto”, me targa ***, të “****” sh.p.k., si dhe kursimet nga puna, shpërblime si ekspert, e drejta e autorit, puna si avokate, etj. Vlera: 3.600 euro. Pjesa takuese: 100 %.

7.2 Në lidhje me këtë pasuri, subjekti ka bashkëlidhur dokumentacion ligjor justifikues⁶¹.

7.3 Në lidhje me përputhshmërinë e deklaramit, Komisioni vlerëson se përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit.

7.4 Nga hetimi i Komisionit u konstatua se nga dokumentacioni i administruar nga DPSHTRR-ja⁶² dhe praktika e dërguar nga zyra noteriale e noterit Sh.Gj.⁶³, konfirmohet se personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, me kontratën e shitjes nr. ***, datë 14.5.2014, i ka shitur blerësit “Punto Biznes” sh.p.k., automjetin në pronësi të saj tip “Fiat Punto”, në vlerën

⁶¹ Certifikatë pronësie datë 15.5.2014, për automjetin tip “Daimler Chrysler”, me targa ***, në emër të znj. J.R.; kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 14.5.2014, blerës znj. J.R., për automjetin tip “Daimler Chrysler”, me targa ***, në vlerën 3.600 euro; kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 14.5.2014, shitës znj. J.R., për automjetin tip “Fiat”, me targa ***, në shumën 900 euro.

⁶² Shkresa nr. *** prot., datë 14.10.2019 e DPSHTRR-së, bashkëlidhur dosja e automjetit me targa ***, tashmë me targa ***.

⁶³ Shkresa nr. *** prot., datë 15.10.2019, plus praktika e automjeteve bashkëlidhur.

900 euro. Personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, po në datën 14.5.2014, me kontratën e shitjes nr. *** (me palë shitëse “***” sh.p.k., dhe blerës znj. J.R.) ka blerë automjetin tip “Daimler Chrysler C220 CDI”, me targa ***, në vlerën 3.600 euro.

7.5 Referuar deklarimeve të personit të lidhur, në çmimin e këtij automjeti është përfshirë edhe shitja e automjetit të mëparshëm në vlerën 900 euro.

7.6 Në deklaratën e interesave private të vitit 2014, personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, deklaroi se shitësit të automjetit i ka shitur automjetin tip “Fiat Punto” kundrejt vlerës 900 euro, duke ulur kështu çmimin përfundimtar të automjetit tip “Benz Daimler Chrysler” në vlerën 3.600 euro, nga 4.500 euro që do ta kishte blerë në të kundërtën.

7.7 Gjithashtu, në kontratën e shitjes nr. ***, për automjetin tip “Daimler Chrysler” në vlerën 3.600 euro, citohet se: *“Këtë pronë, unë, shitësi me vullnetin tim të lirë, deklaroj se ia shes znj. J.R. me një çmim prej 3.600 euro, shumë të cilën e kam marrë dhe kam bërë dorëzimin e mjetit”*.

7.8 Si konkluzion, Komisioni vlerëson se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar dhe personi i lidhur ka të ardhura të ligjshme, shoqëruar me dokumentacion justifikues për blerjen e këtij automjeti.

8. Depozitë me afat 1-vjeçar në “Bankën Kombëtare Tregtare” sh.a.

Faktet nga hetimi administrativ kryesisht, shpjegimet dhe provat e subjektit në përgjigje të barrës së provës, si dhe seanca dëgjimore

8.1 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017 personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar se ka një depozitë me afat 1-vjeçar në “Bankën Kombëtare Tregtare” sh.a. Vlera: 15.000 euro. Pjesa takuese: 100 %.

8.2 Si burim krijimi subjekti deklaroi: depozita e mëparshme në lekë në BKT sh.a., kursime nga puna, shpërblimet nga projektet e ndryshme, e drejta e autorit, puna si avokate etj.

8.3 Subjekti, për vërtetimin e deklarimeve, ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁶⁴.

8.4 Nga dokumentacioni i administruar nga BKT⁶⁵ konfirmohet se subjekti i rivlerësimit, në datën 23.1.2017, ka një depozitë në vlerën 15.000 euro, krijuar në datën 3.8.2016. Konstatohet se kjo depozitë vjen nga: shuma 14.826,86 euro, e konvertuar nga llogaria e depozitës⁶⁶ në lekë të personit të lidhur, bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit; dhe shuma 173,14 euro, e konvertuar nga llogaria e pagës së personit të lidhur, bashkëshortes.

8.5 Në lidhje me mjaftueshmërinë e burimit të krijimit – nga analizimi i të ardhurave të ligjshme, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të mjaftueshme për krijimin e kësaj depozite bankare.

⁶⁴ Kontratë depozite me BKT-në në emër të znj. J.R., lidhur në datën 2.8.2016, në shumën 15.000 euro, të dhëna bankare datë 17.3.2016; vërtetim nr. ***, datë 12.1.2017, *statement* nga “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a., datë 16.11.2016.

⁶⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 15.1.2019.

⁶⁶ Depozitë e krijuar me dy transferata nga llogaria e pagës te llogaria e depozitës (1.500.000 lekë, datë 6.6.2012 dhe 300.000 lekë, datë 9.6.2014).

8.6 Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë depozitë në BKT, si dhe ka burime të ligjshme shoqëruar me dokumentacion justifikues ligjor për krijimin e saj.

9. Kursime cash në euro dhe lekë, të mbledhura gjatë viteve

Faktet nga hetimi administrativ kryesisht, shpjegimet dhe provat e subjektit në përgjigje të barrës së provës, si dhe seanca dëgjimore

9.1 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar kursime në gjendje *cash* në euro dhe lekë, në vlerën 6.000 euro + 450.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

9.2 Si burim krijimi subjekti deklaron se kanë shërbyer paga dhe shpërblime të tjera të kursyera ndër vite.

9.3 Subjekti, për vërtetimin e deklarimeve, ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁶⁷.

9.4 Referuar deklaratës së interesave private të vitit 2014, bashkëshortja e subjektit deklaron shumën 6.000 euro, me burim krijimi: kursimet e deritanishme nga puna, shpërblime nga projektet e ndryshme, e drejta e autorit, puna si avokate, etj.

9.5 Subjekti i rivlerësimit, në pyetësonin nr. 2, deklaron se ka filluar të bashkëjetojë me bashkëshorten në tetor të vitit 2013.

9.6 Bazuar në deklaratat periodike të interesave private, Komisioni konstaton se shuma prej 450.000 lekësh është krijuar gjatë periudhës 2014 – 2016, pra, përgjatë periudhës së bashkëjetesës me subjektin e rivlerësimit. Për këtë arsye, analizimi i burimit të ligjshëm për këtë shumë u përfshi në pikën 5.

9.7 Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e personit të lidhur, bashkëshortes, për periudhën 2004 – 2013 (që nga momenti fillestar i krijimit të të ardhurave deri në fund të vitit 2013), si më poshtë vijon:

Përshkrim	Vlerë
Të ardhurat e dokumentuara	6,126,950
Shpenzime jetike 1 person (2004 – 2013) ⁶⁸	-1,315,578
Shpenzime <i>TIMS</i>	-249,556
Shpenzime pjesëmarrjeje dhe publikimi ⁶⁹	-37,293
Shpenzime për blerje automjeti tip “Daimler Chrysler”	-504,504
Shpenzime për blerje automjeti tip “Fiat Punto” ⁷⁰	- 150,000

⁶⁷ Vërtetim nr. ***, datë 12.1.2017; kontrata në datat 10.1.2014, 10.10.2013; kontratë botimi datë 5.7.2013; kontratë botimi datë 3.2.2015, *statement* datë 20.1.2017.

⁶⁸ Shkresë nr. ***, datë 4.3.2019, e ILDKPKI-së (vlera për vitin 2007 e saktësuar sipas shkresës nr. ***, datë 27.5.2008, së INSTAT-it, drejtuar ILDKPKI-së).

⁶⁹ Shpenzime të evidentuara në lëvizjet e llogarive bankare në BKT.

⁷⁰ Kontratë nr. *** prot., nr. *** rep., datë 15.10.2008.

Shpenzime mjekësore ⁷¹	- 167,776
Gjendje llogari bankare datë 31.12.2013	-1,827,159
Gjendje <i>cash</i> 6.000 euro	-840,840
Balanca e fondeve	1,034,244

9.8 Në lidhje me mjaftueshmërinë e burimit të krijimit – nga analizimi i të ardhurave të ligjshme, Komisioni arrin në konkluzionin se personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, ka pasur burime të mjaftueshme për krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar.

9.9 Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme, shoqëruar me dokumentacion justifikues ligjor për krijimin e kursimeve *cash*.

GJETJE TË TJERA GJATË HETIMIT

10. Dhurimi i automjet tip “Mercedes Benz 190 D”, nga vëllai i subjektit, personi tjetër i lidhur, A.V.

Faktet nga hetimi administrativ kryesisht, shpjegimet dhe provat e subjektit në përgjigje të barrës së provës, si dhe seanca dëgjimore

10.1 Në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2006, subjekti ka deklaruar se zotëron një automjet tip “Mercedes Benz 190 D”, fituar me dhurim në datën 22.1.2005, në vlerën 600.000 lekë.

10.2 Nga dokumentacioni i administruar nga DPSHTRR-ja⁷² bëhet me dije se subjekti i rivlerësimit ka pasur të regjistruar automjetin tip “Mercedes Benz”, me targa ***, për periudhën 16.2.2005 – 2.3.2015. Më tej, për periudhën 2.3.2015 – 20.11.2018, ky automjet figuron i regjistruar në emër të personit tjetër të lidhur, A.V.

10.3 Refruar kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 30.12.2004, rezulton se automjeti tip “Mercedes Benz” është blerë nga z. A.V. (i vëllai i subjektit), në vlerën 1.300 euro + shpenzimet doganore 188.155 lekë.

10.4 Referuar kontratës së dhurimit nr. ***, datë 22.1.2005, z. A.V. ia dhuron këtë automjet subjektit të rivlerësimit, pa asnjë kundërshtëpërblim apo detyrim tjetër financiar pas më pak se një muaj nga blerja.

10.5 Më vonë, subjekti, me kontratën e dhurimit nr. ***, datë 23.2.2015, ia ka dhuruar këtë automjet babait të tij, personit tjetër të lidhur, A.V.

10.6 Personi tjetër i lidhur, A.V., e ka shitur automjetin me kontratën nr. ***, datë 14.11.2018, në shumën 50.000 lekë.

⁷¹ Deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në pyetëtorin standard.

⁷² Shkresa nr. *** prot., datë 14.10.2019.

10.7 Duket se ka mospërputhje lidhur me vlerën e automjetit të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006 dhe çmimit të konstatuar nga Komisioni gjatë hetimit.

10.8 Për të sqaruar mospërputhjet, në pyetësonin nr. 3, subjektit të rivlerësimit i kërkohet të japë shpjegime lidhur me këtë dhurim, si dhe të dorëzojë dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e dhuruesit.

10.9 Në përgjigje të pyetësorit, subjekti deklaroi se automjetin e mësipërm e ka përfituar si dhurim nga vëllai i tij, personi tjetër i lidhur, A.V. Subjekti deklaroi se: *“Dëshiroj të saktësoj se vlera e automjetit e shënuar prej meje 600.000 lekë në deklaratën e pasurisë së vitit 2006, është vlerë subjektive e imja dhe e shënuar në lajthim e sipër, pa u konsultuar me dokumentet e blerjes së automjetit. Kjo pasi, realisht automjeti i blerë ishte i vitit 1990 dhe në kohën që u ble kishte rreth 14 vjet përdorim. Im vëlla e ka blerë atë automjet me kontratën nr. ***, datë 30.12.2004, në vlerën 1,300 euro. Ky automjet është zhdoganuar nga vëllai im sipas mandatit bankar të datës 30.12.2004, në vlerën 188.155 lekë, siç konfirmohet edhe nga deklarata doganore nr. ***, datë 30.12.2004. Pra, vlera e automjetit që më dhuroi im vëlla është 1.300 euro (kursi sipas deklaratës doganore 128 lekë/euro) + 188.155 lekë = 354.555 lekë. Vlera e mësipërme është mbuluar pjesërisht me kursimet e vëllait nga puna si punonjës policie dhe pjesërisht nga kursimet e prindërve. Theksoj se vëllai im ka bashkëjetuar me prindërit dhe me mua nga korriku 2004 deri në shtator 2008”.*

10.10 Në përfundim, subjekti deklaroi se automjetin me targa *** ia ka dhuruar babait, personit tjetër të lidhur, A.V., me kontratën e dhurimit nr. ***, datë 23.2.2015, duke mos pasur kësaj ndonjë shtesë pasurie permanente nga ky automjet.

10.11 Bashkëlidhur, subjekti ka paraqitur dokumentacion provues ligjor për të ardhurat e vëllait, personit tjetër të lidhur, A.V., për periudhën që ka qenë pjesë e familjes së subjektit.

10.12 Ky automjet është blerë nga personi tjetër i lidhur, A.V., në 30 dhjetor 2004 dhe i është dhuruar subjektit në 22 janar 2005.

10.13 Si konkluzion, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm mospërputhjet që ekzistonin në lidhje me vlerën e automjetit të deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006 dhe personi tjetër i lidhur, vëllai i subjektit të rivlerësimit, ka pasur të ardhura të ligjshme për të blerë këtë automjet.

B. PROCESI I RIVLERËSIMIT TË KONTROLLIT TË FIGURËS

1. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

2. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 26.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 8.1.2019, të KDZH-së, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

3. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit, z. Asim Vokshi: (a) ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar; (b) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej tij në deklaratën për kontrollin e figurës; (c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

4. Si konkluzion, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Asim Vokshi.

5. Pavarësisht raportit të dërguar nga DSIK-ja, Komisioni ka kryer hetim administrativ, prej të cilit rezulton se konstatimet e Grupit të Punës për kontrollin e figurës janë të sakta.

6. Më tej, Komisioni konstatoi se nuk ka asnjë informacion apo *indicie* që të implikojë subjektin në kryerjen e ndonjë vepre penale apo cenim të figurës, nuk ka denoncime apo të dhëna të tjera që të rezultojë se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me 24 personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

7. Në përfundim, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit e ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në kohën e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016; nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe nuk ka bërë deklaramit të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

8. **Si konkluzion**, Komision vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka dorëzuar raportin profesional për subjektin e rivlerësimit.

2. Nga vlerësimi i tri dokumenteve të përzgjedhura nga subjekti dhe pesë dosjeve të përzgjedhura me short, lidhur me kriteret e vlerësimit, sipas ligjit nr. 96/2016, janë vënë re këto gjetje:

2.1 Lidhur me njohuritë ligjore – subjekti i rivlerësimit, z. Asim Vokshi, ka aftësi të mira në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, identifikon shumë qartë normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret; ka njohuri mbi të drejtën e pronësisë dhe tagrën e posedimit mbi detyrimet kontraktore, mbi të drejtën tregtare, mbi të drejtën e punës, mbi titujt ekzekutivë dhe veprimet përmbartimore, si dhe mbi gjykimin e kërkesave gjatë hetimeve paraprake. Subjekti njeh dhe përdor shprehimisht parimet e përgjithshme të teorisë së të drejtës si: (i) parimi i barrës së provës tek i padituri; (ii) disponimi i të drejtës së padisë nga paditësi. Subjekti evidenton qartësisht natyrën e mosmarrëveshjes dhe

gjykatën kompetente. Norma ligjore identifikohet në mënyrë të qartë prej tij. Subjekti i rivlerësimit ka aftësi procedurale, ndjek procedurën e parashikuar nga ligji, duke disponuar me vendime të ndërmjetme, të cilat paraqiten të arsyetuara dhe përgjithësisht përmbajnë bazë ligjore të shprehur.

2.2 Lidhur me arsyetimin ligjor – subjekti i rivlerësimit, z. Asim Vokshi, ka aftësi në arsyetimin ligjor me cilësi dhe ndjek metodën e ndarjes së vendimit në pjesë: (i) juridiksioni dhe kompetenca; (ii) faktet objekt mosmarrëveshjeje; (iii) pretendimet e palëve; (iv) ligji i zbatueshëm; (v) arsyetimi i gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Paragrafët e secilës nëndarje numërtohen rregullisht.

Gjyqtari përdor gjerësisht përmbajtjen e dispozitave civile materiale dhe procedurale, si dhe duke cituar dhe përdorur gjerësisht edhe ligjet e posaçme. Gjyqtari i kushton kujdes përfshirjes në arsyetimin e vendimit përfundimtar të pretendimeve apo prapësimeve thelbësore të palëve si: legjitimiteti i palëve në proces apo rrëzimi i kërkesës për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, arsyetimit të çdo pretendimi të paraqitur prej palëve në gjykim. Nga pikëpamja formale, vendimet përfundimtare plotësojnë, sipas rastit, kërkesat e legjislacionit procedural penal apo kërkesat e legjislacionit procedural civil, përdor rregullisht të gjitha karakteret e gjuhës shqipe dhe i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme.

2.3 Lidhur me aftësitë organizative – gjyqtari Asim Vokshi ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë. Arsyetimi i vendimeve gjyqësore, përgjithësisht, është brenda afatit. Në këto të dhëna mbahet në konsideratë ngarkesa sasiore mbi standardin minimal, si dhe kompleksiteti i çështjeve. *Në lidhje me aftësinë për të kryer procedura gjyqësore*, subjekti i rivlerësimit, z. Asim Vokshi, është efektiv në përfundimin në kohë të gjykimeve, që është tregues i lidhur me aftësitë për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim. Subjekti kryen veprime produktive përgatitore me qëllim përgatitjen e çështjes për gjykim të shpejtë në seancë gjyqësore, të cilat dokumentohen me procesverbal të rregullt nga pikëpamja formale. Gjatë gjykimit, gjyqtari Asim Vokshi identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe zhvillon siç duhet procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve, prezantimin e gjykatës, debatin dhe hetimin gjyqësor, pohimet e palëve, marrjen e provave, kërkimet dhe prapësimet e palëve deri në shpalljen e vendimit. *Në lidhje me aftësinë për të administruar dosjet*, përgjithësisht aktet themelore janë të rregullta, të sakta dhe të plota. Procesverbali gjyqësor dokumenton kohën dhe vendin, si dhe veprimet që kryhen në seancë. Në të pesë dosjet gjyqësore janë përfshirë rregullisht padia dhe provat e paraqitura nga paditësi në procesin civil apo kërkesa e të arrestuarit dhe provat përkatëse, aktet e njoftimit të palëve; kërkesat me shkrim të palëve dhe provat e paraqitura prej tyre, procesverbali përgatitor dhe ai gjyqësor, vendimi gjyqësor dhe urdhri i ekzekutimi kur është lëshuar nga gjykata.

2.4 Lidhur me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale – për subjektin e rivlerësimit, z. Asim Vokshi, nuk ka të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Nuk rezultojnë raste të konfliktit të interesit dhe nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve. Asnjë prej dokumenteve ligjore dhe dosjeve të vëzhguara nuk lidhen me çështje të tjera të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore, të pakicave

apo të të miturve. Subjekti nuk përdor gjuhë diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e tij.

2.5 Lidhur me aftësitë personale dhe angazhimin profesional – subjekti Asim Vokshi ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje profesionale dhe etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe duke respektuar barazinë e palëve. Gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë. *Në lidhje me aftësinë për të bashkëpunuar*, rezulton se nuk ka pasur vonesa në arsyetimin e vendimeve gjyqësore, si e dhënë e tërthortë, ndërsa nuk ka pasur dështime të seancave për shkak moskryerje njoftimesh në kohë, çfarë tregon produktivitetin e punës së subjektit në këtë aspekt. Seancat, kryesisht, kanë dështuar për pamundësi të njoftimit të palëve në adresat e deklaruara nga pala paditëse. *Në lidhje me gatishmërinë për t'u angazhuar*, subjekti i rivlerësimit, z. Asim Vokshi, ka marrë titullin “Magjistrat gjyqtar”, nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2006. Gjyqtari Asim Vokshi i ka kushtuar rëndësi formimit akademik duke u diplomuar “Master në Shkenca Civile” në periudhën 2006 – 2008 në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, si dhe mban gradën shkencore “Doktor i Shkencave Juridike Civile” fituar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, prej vitit 2015. Subjekti i rivlerësimit zotëron Ll M nga Universiteti i San Diegos në biznes dhe korporata ligjore. Në periudhën e rivlerësimit, ka marrë pjesë në 9 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës ku dhe është certifikuar. Këto të dhëna tregojnë se z. Asim Vokshi ka marrë pjesë në 15 ditë trajnim gjithsej. Subjekti, gjithashtu ka marrë pjesë si ekspert dhe si lehtësues në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, në aktivitetet trajnuese me temë: “Aspektet procedurale të së drejtës së padisë”, të organizuara përkatësisht në datat 26-27 maj 2014, 28-29 janar 2015 dhe 7 prill 2015.

3. Konkluzione për rivlerësimin e aftësive profesionale

Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha fakteve dhe provave në raport me ligjin e zbatueshëm, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv dhe konsiderohet “i aftë”. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Asim Vokshi, ka nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

4. Të dhëna nga burime arkivore të KLD-së

4.1 Nga informacioni i dërguar nga KLGJ-ja në lidhje me ankesat për gjyqtarin Asim Vokshi në KLGJ (ish-KLD), konstatohet se sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Asim Vokshi janë paraqitur 9 ankesa (1 në vitin 2013, 6 në vitin 2014, dhe 2 në vitin 2016) në Inspektoratin e KLD-së. 4 prej ankesave (3 të vitit 2014, 1 e vitit 2016) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, ndër të cilat 2 ankesa me arsyetimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor dhe 2 ankesa me arsyetimin se janë ankesa të përsëritura më parë. 5 ankesa janë verifikuar dhe rezultatet janë si vijon: (i) 1 ankesë e vitit 2013, verifikuar për shkelje etike, është arkivuar pasi pretendimet janë të pabazuara; (ii) 2 ankesa të vitit 2014, verifikuar bazuar mbi informacionin periodik të ardhur nga kryetari i gjykatës në lidhje me vendimet e cenuara, i janë regjistruar gjyqtarit për efekt vlerësimi profesional dhe etik; (iii) 1 ankesë e vitit 2014, verifikuar për

zvarritje dhe mosrespektim formal ligji, është arkivuar pasi pretendimet janë të pabazuara; (iv) 1 ankesë e vitit 2016 është në proces verifikimi për zvarritje gjykimi.

4.2 Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Asim Vokshi përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

4.3 Në përfundim, Komisioni, pasi mori në shqyrtim ankesat e depozituara në KLD, si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore, të analizuar nga KLD-ja, vlerëson se nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

DENONCIMET NGA PUBLIKU

1. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Asim Vokshi, janë administruar denoncime nga publiku, si më poshtë vijon: (1) denoncimi nr. *** prot., datë 14.11.2017, i shtetasit L. B. Ky denoncim nuk referon asnjë pretendim apo provë lidhur me subjektin e rivlerësimit, z. Asim Vokshi, dhe nuk ka *indicie* për hetime të mëtejshme ndaj subjektit; (2) denoncimi nr. ***, datë 28.3.2018, i shtetasit A. Sh., i cili akuzon disa subjekte rivlerësimi, ndër ta edhe z. Asim Vokshi, për vendimmarrje të padrejtë, veprime korruptive dhe vjedhje të dokumenteve nga dosja gjyqësore. Denoncuesi pretendon se gjykimi duhet të ishte ndërprerë, për sa kohë lidhur me objektin e gjykimit ishte filluar një procedim penal; (3) denoncimet nr. *** prot., datë 20.4.2018; nr. ***, datë 27.6.2018; nr. *** prot., datë 18.12.2018, dhe nr. *** prot., datë 7.2.2018, të shtetasit H. R., me objekt: vënia në dispozicion e vendimit civil të arsyetuar brenda afateve ligjore dhe problematikat e çështjes së pronësisë së denoncuesit; (4) denoncimi nr. *** prot., datë 4.6.2018 i shtetasit G. Sh., i cili kërkon fillimin e procedimit disiplinor ndaj subjektit, pasi në mënyrë të qëllimshme nuk ka hequr dorë nga gjykimi i çështjes; (5) denoncimet nr. *** prot., datë 22.6.2018; nr. *** prot., datë 15.1.2019 dhe nr. *** prot., datë 18.1.2019, të shtetasit Gj. dhe M. P., të cilët akuzojnë subjektin e rivlerësimit, z. Asim Vokshi, për dhënien e një vendimi korruptiv; (6) denoncimi nr. *** prot., datë 26.6.2018, i shtetasit P. B., i cili denoncon një subjekt rivlerësimi që ka shqyrtuar çështjen në shkallë të parë, si dhe anëtarët e trupit gjykues në Gjykatën e Apelit Tiranë, midis tyre edhe subjekti Asim Vokshi, për arsye se kanë lënë në fuqi vendimin, duke i shkaktuar dëm ekonomik; (7) denoncimi nr. *** prot., datë 18.7.2018, i shtetasit Sh. H., i cili ankohet për disa subjekte rivlerësimi, ndërmjet tyre edhe subjekti Asim Vokshi. Denoncuesi pretendon se subjekti, si pjesë e trupit gjykues, ka dhënë një vendim të padrejtë; (8) denoncimet nr. ***, datë 19.7.2018; nr. ***, datë 17.7.2019; nr. ***, datë 7.2019 dhe nr. ***, datë 21.5.2019, të shtetasës R. R., e cila ankohet për disa subjekte rivlerësimi, ku ndër të tjerë edhe gjyqtari Asim Vokshi, duke i akuzuar për korrupsion dhe njëanshmëri, shpërdorim detyre dhe vendimmarrje të qëllimshme; (9) denoncimi nr. *** prot., datë 12.10.2018, i paraqitur nga një shtetas anonim, i cili identifikohet si oficer i policisë së shtetit. Në këtë denoncim përmenden tre subjekte rivlerësimi, ndër ta edhe subjekti Asim Vokshi, lidhur me vendimin e marrë për ndryshimin e masës së sigurimit personal të një të pandehuri të dyshuar për veprën penale “dhunë në familje”; (10) denoncimi nr. ***, datë 29.10.2018, i paraqitur nga shtetasi A. K., i cili pretendon se Gjykata e Apelit Tiranë, ku në përbërje të trupit gjykues është edhe subjekti, ka cenuar të

drejtat e tij legjitime për arsye se ka favorizuar palën kundërshtare, e cila nuk ka pasur prova ligjore; (11) denoncimi nr. *** prot., datë 1.2.2019, i shtetasit A. K., i cili i referohet 5 subjekteve të rivlerësimit që kanë shqyrtuar konfliktin e tij, midis të cilëve edhe subjekti Asim Vokshi. Denoncuesi ankohet se çështja gjyqësore është zgjidhur brenda dy muajve, në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve, duke pranuar një vendim gjykate, i cili ka tjetërsuar objektin e padisë së kërkuar; (12) denoncimi nr. ***, datë 11.2.2019, i shtetasit H. C., i cili ankohet se subjekti i rivlerësimit, z. Asim Vokshi, ka marrë një vendim të padrejtë, të pambështetur ne prova dhe zvarritje të procesit gjyqësor; (13) denoncimet nr. ***, datë 11.3.2019; nr. ***, datë 4.10.2019 dhe nr. ***, datë 15.5.2019, të shtetasit V. Ç., i referohen disa subjekteve të rivlerësimit, të cilët i akuzon për korrupsion dhe kontakte të papërshtatshme; (14) denoncimi nr. *** prot., datë 13.3.2019, i shtetasit D. N., i cili ankohet për disa subjekte rivlerësi, përfshirë edhe subjektin Asim Vokshi, lidhur me veprime korruptive në dhënien e vendimeve; (15) denoncimi nr. *** prot., datë 21.6.2019, i shtetasit K. M., i cili akuzon subjektin e rivlerësimit, z. Asim Vokshi, për korrupsion, dhënien e një vendimi të padrejtë, gjykim të njëanshëm, nuk ka marrë parasysh asnjë nga provat e depozituara nga denoncuesi dhe ka pranuar një ekspertizë të falsifikuar; (16) denoncimi nr. *** prot., datë 21.6.2019, i shtetasit M. T., e cila së bashku me shtetasin J. Zh., akuzojnë disa subjekte rivlerësi, ndër ta edhe subjektin Asim Vokshi, për shkelje në gjykim për arsye përfitimi. Gjyqtarët e këtij trupi kanë injoruar disa vendime të mëparshme të Gjykatës së Tiranës të formës së prerë, ka pasur zvarritje të procesit dhe rigjykim të çështjes. (17) denoncimi nr. *** prot., datë 26.6.2019, i shtetasit A. Z., i cili akuzon disa subjekte rivlerësi, ndër ta edhe subjektin Asim Vokshi. Sipas denoncuesit, trupi gjykues, ka marrë vendim pa lexuar dhe pa marrë parasysh parashtrimet e paraqitura në seancë; (18) denoncimet nr. *** dhe nr. *** prot., datë 19.9.2019, të shtetasit A. Sh., i cili akuzon subjektin e rivlerësimit, z. Asim Vokshi, për vendimmarrje të padrejtë, zvarritje të procesit gjyqësor, si dhe nuk i është dhënë e drejta e fjalës gjatë gjykimit; (19) denoncimi nr. ***, datë 19.12.2019, i shtetasit E. Z., i cili akuzon disa subjekte rivlerësi, ndër ta edhe subjektin Asim Vokshi, pasi vendimi i dhënë është i padrejtë, në shkelje flagrante të ligjeve në fuqi, shkelje e procesit të rregullt ligjor nga një trup gjyqësor i korruptuar; (20) denoncimi nr. ***, datë 26.2.2020, i shtetasit L. T., me objekt: cenimi i standardit për një proces të rregullt ligjor nga subjekti i rivlerësimit, z. Asim Vokshi. Bashkëlidhur këtij denoncimi nuk është paraqitur dokumentacion provues.

2. Nga hetimi dhe shqyrtimi i denoncimeve të pasqyruara më lart, Komisioni, në mbështetje të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arriti në përfundimin se nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

3. Më tej, Komisioni vëren se në njërin prej denoncimeve, me nr. ***, datë 20.2.2020, i shtetasit F. Xh., konstatohen disa problematika, si më poshtë:

4. Denoncuesi F. Xh. ankohet për shkelje të etikës dhe zvarritje të procesit gjyqësor. Sipas tij, subjekti i rivlerësimit, në gjykimin e çështjes, por edhe në arsyetimin e vendimit, nuk zbaton ligjin material dhe procedural, nuk ka marrë për bazë dhe as nuk ka arsyetuar pretendimet e të paditurit dhe në rastet kur i ka arsyetuar, i ka arsyetuar pjesërisht.

5. Nga aktet e administruara, në këtë denoncim, rezulton se denoncuesi F. Xh. është në cilësinë e palës së paditur, në çështjen me objekt “Detyrimin e të paditurit të përmbushë aktmarrëveshjen nr. ***, datë 20.3.2010. Detyrimin të njohë pronare znj. N. XH. për pasuritë: ap. me sip. 26.5 m², dhe truall 345 m², mbi të cilën është ndërtuar një ndërtesë, Urdhërimin e ZVRPP-së të bëjë regjistrimin e këtyre pasurive në emër të znj. N.XH.”, kjo çështje në shkallë të parë është gjykuar nga subjekti i rivlerësimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 23.12.2011, ka vendosur pranimin e pjesëshëm të padisë. Ndërkohë që Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 17.10.2012, ka vendosur prishjen e vendimit të shkallës së parë dhe pushimin e gjykimit të çështjes, duke dalë në këto konkluzione: *Qëndrimi i mbajtur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit material dhe procedural. Gjykimi i kërkesë-padisë cenon sigurinë juridike, duke shkelur rëndë parimin e gjësë së gjykuar.*

6. Në lidhje me sa më lart, gjatë mbrojtjes, subjekti deklaroi se ky gjykim është bazuar në nenin 58, të Kodit të Procedurës Civile, ku është argumentuar se padia që rrjedh nga kontrata e lidhur midis palëve nuk është e njëjtë me atë për pjesëtimin e sendit midis të njëjtave palë, pasi ndryshon jo vetëm objekti, por edhe shkaku i padisë. Subjekti sqaroi se nuk është cenuar parimi i gjësë së gjykuar, pasi në rastin konkret objekt gjykimi ishte një kontratë noteriale, me anë të së cilës palët zgjidhnin mosmarrëveshjet e tyre pasurore. Kontrata e lidhur rregullisht nuk mund të zgjidhet në mënyrë të njëanshme nga njëra prej palëve, por vetëm gjyqësisht. Pretendimet e të paditurit për pavlefshmëri relative (lajthim, mashtim) nuk janë marrë parasysh nga gjykata, pasi duhej të silleshin në gjykim në formën e kundërpadisë. Subjekti, gjithashtu, argumentoi se vendimi i Gjykatës së Apelit, duke pushuar gjykimin, nuk ka sjellë asnjë pasojë për denoncuesin.

7. Pas analizimit të vendimit nr. ***, datë 23.12.2011, Komisioni vëren se çështja është zgjidhur duke u gjykuar vetëm ajo mosmarrëveshje që ka qenë objekt gjykimi dhe gjykata është shprehur vetëm për pronat e regjistruara në ZVRPP-në Tiranë.

8. Më tej, vlerësohet se në tërësi pretendimet e denoncuesit ngrihen mbi themelin e vendimit (pra, kanë të bëjnë me gjykimin e fakteve dhe zbatimin e ligjit). Bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni analizon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet.

9. Për sa më sipër, Komisioni çmon se kjo çështje duhet të transferohet në bazë të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit kompetent për inspektim, për të verifikuar nëse evidentohen shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore, sipas ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ose nëse ka shkaqe për t’u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të subjektit të rivlerësimit.

10. Në të gjitha çështjet e analizuara, subjekti shfaq aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, si dhe në kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor. Subjekti i rivlerësimit zotëron njohuritë ligjore dhe të arsytimit ligjor, referuar nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

11. Si konkluzion, Komisioni vlerësoi se çështja e përmendur më lart nuk është e mjaftueshme për ta kualifikuar subjektin e rivlerësimit si “me mangësi” apo “i papërshtatshëm” në drejtim të vlerësimit të kriterit të aftësisë profesionale, në kuptim të germave “b” dhe “c”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme. Gjithashtu, çështja e përmendur nuk përbën shkak që mund ta çonte trupin gjykues në përfundimin se subjekti i vlerësimit ka cenuar besimin e publikut të dhënia e drejtësisë, në kuptim të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Asim Vokshi, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- d. Në lidhje me çështjen me nr. *** Akti, nr. *** Vendimi, nr. *** Regjistri Themeltar, datë 23.12.2011, Trupi Gjykues vlerëson se në zbatim të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, kjo çështje duhet të transferohet pranë organit kompetent për inspektim, nëse evidentohen shkaqe për t’u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të tij.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, dhe referuar germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, pikave 1 dhe 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Asim Vokshi.

2. Në zbatim të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, të transferojë çështjen me nr. *** Akti, nr. *** Vendimi, nr. *** Regjistri Themeltar, datë 23.12.2011, pranë organit kompetent për inspektim, nëse evidentohen shkaqe për t'u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të tij.
 3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
 4. Ndaj këtij vendimi, me përjashtim të pikës 2, mund të ushtrohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
 5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 28.2.2020

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Genta Tafa (BUNGO)
Kryesuese

Etleda ÇIFTJA
Relatore

Suela ZHEGU
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj